



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 681 Akti

Nr. 722 Vendimi
Tiranë, më 7.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në datën 5.12.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ritvan Suka**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *mungesë dokumentacioni (dokumentacion jo i plotë) ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime ndër vite;*

¹ Akti i përfundimit të kontrollit nr. *** prot., datë 16.1.2018.

- nuk ka kryer deklarin të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportet² e mbajtura për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, duke ka dërguar një raport³ të hollësishtëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 14.11.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 14.11.2023 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 16.11.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 30.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.11.2023).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 1.12.2023.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.12.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017 dhe nr. *** prot., datë 8.5.2023, i AKSIK-së, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 10.5.2023, të KDZH-së.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 21.11.2022.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Ritvan Suka ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësisë profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e)

⁴“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato dhëna gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka.

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

23. Pasuria e llojit apartament banimi (në bashkëpronësi me bashkëshorten) me sipërfaqe banimi 91.7 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 13.3 m², ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, pallati “****”, shkalla nr. ***, apartamenti nr. ***, blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 27.6.2015, në bazë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 48,800 euro.

23.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) kursimet nga pagat në shumën 19,800 euro, duke referuar dy pagesa të kryera me këtë burim, konkretisht një pagesë të kryer në datën 22.1.2013 (vlera 15,000 euro) dhe pagesa tjetër e kryer në datën 25.6.2015 (vlera 4,800 euro); (ii) kredinë bankare në shumën 25,000 euro, marrë në datën 7.3.2013 në Societe Generale Albania; (iii) dhurimin në shumën 4,000 euro, duke e referuar si pagesë të kryer nga babai në datën 8.7.2013, me kursimet nga puna e tij si emigrant në shtetin italian në vitet 2000 – 2010.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

23.2 Në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “(i) Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2013, para noteres D.P, me firmën “****”, për blerjen e një apartamenti në ***, Tiranë, me sipërfaqe 111.8 m², në vlerën 53,500 euro. Pagesa e shumës me katër këste, paguar firmës “****” 44,000 euro: (a) më datë 22.1.2013, shuma 15,000 euro; (b) më datë 7.3.2013, shuma 25,000 euro; (c) më datë 8.7.2013, paguar shuma 4,000 euro; (ii) Revokim i kontratës datë 16.1.2013, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2013; (iii) Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2013, për blerjen e apartamentit në ***, Tiranë, me sipërfaqe 105 m², në shumën 48,800 euro”.

23.2.1 Ndërsa, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: “(i) Kredi në shumën 25,000 euro, marrë në bankën Societe Generale Albania, me nr. ***, e lidhur në datën 7.3.2013, për një periudhë 15-vjeçare, deri në datën 7.3.2028, me interes 6%, kësti mujor 220 euro. Shuma e shlyer nga deklarimi mëparshëm, në vlerën 2,010 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur në vlerën 37,423 euro; (ii) Detyrim ndaj firmës “****” në shumën 53,500 euro, pas revokimit të kontratës 48,800 euro. Shuma e shlyer 44,000 euro (15,000 euro kursimet familjare, 25,000 euro kredi në bankën Societe Generale Albania dhe 4,000 euro paguar nga babai H.S, të ardhura të kursyera nga familja e tij”.

23.3 Në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “Në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2015, mbajtur përpara noteres D.P, ka kaluar në pronësi apartamenti i porositur te firma “****”, me adresë ***, rruga “****”, pallati “****”,

shk. ***, ap. ***, Tiranë, me vlerë 48,800 euro, duke referuar të dhënat e regjistrimit të kësaj pasurie”.

23.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: (i) Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja dhe DPPP-ja; (ii) Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për pagesën në vitin 2015 të kështit 4,800 euro, për apartamentin me sipërfaqe 91.7 m², në lagjen “****”, rruga “****”, pallati “****”, Tiranë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24. Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së saj⁵, Komisioni konstaton se:

24.1 Në datën 16.1.2013 është nënshkruar kontrata e porosisë (për prenotim apartamenti)⁶ mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt porositjen e pasurisë së llojit apartament nr. **, shkalla ***, në katin e tretë banimi, kuota +10.85, me sipërfaqe totale 111.6 m², sipërfaqe të përbashkët 12.8 m² dhe sipërfaqe shfrytëzimi 98.8 m², i ndodhur në godinën e ndërtuar/që po ndërtohej nga kjo shoqëri sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 29.9.2011, të KRRT-së, Komuna Kashar (godinë banimi *** - *** kat + 1 kat nëntokë, në pronë të I.C etj.), për çmimin 53,300 euro.

24.1.1 Referuar kësaj kontrate, plani i pagesave është përcaktuar si vijon (neni 3 i kontratës): (i) brenda datës 24.1.2013 do të likuidohet vlera 15,000 euro; (ii) vlera 25,000 euro do të likuidohet në fund të muajit shkurt 2013; (iii) vlera 5,000 euro, në fillim të muajit qershor 2013; (iv) vlera 5,000 euro do të likuidohet me marrjen e çelësave të apartamentit; (v) vlera 3,500 euro do të likuidohet me marrjen e hipotekës.

24.1.2 Pas shqyrtimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se: (i) në datën 22.1.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në Credins Bank, shumën 15,000 euro, me përshkrimin “Derdhje kësht apartmenti Ritvan Suka”; (ii) në datën 7.3.2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë kaluar nëpërmjet transfertës nga llogaria e tyre e kredisë në Societe Generale Alabania në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 25,000 euro, me përshkrimin “Pagesë kësht blerje apartmenti”; (iii) në datën 8.7.2013, babai i subjektit, z. H.S, ka depozituar *cash* në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 4,000 euro.

24.1.3 Pra, rezulton se deri në datën 8.7.2013 subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën 44,000 euro në funksion të likuidimit të çmimit të blerjes së apartamentit të porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes datë 16.1.2013.

24.2 Në datën 5.12.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k. kanë revokuar⁷ plotësisht kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2013, duke i kthyer palët në gjendjen para redaktimit e nënshkrimit të saj. Gjithashtu, në këtë dokument përcaktohet se kontrata revokohet për arsye se porositësi do të prenotojë apartament në objektin tjetër që po ndërton shoqëria dhe se vlera e dhënë për prenotimin e apartamentit i kalon si vlerë likuidimi për apartamentin tjetër.

24.3 Po në datën 5.12.2013 është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes (për prenotim apartament banimi)⁸ mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt porositjen e pasurisë së llojit apartament banimi

⁵ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.2.2021); (ii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2017, e ZVRPP-së Tiranë, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2013.

⁷ Dokumenti noterial “Revokim kontratë sipërmarrjeje (për prenotim apartament)” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2013.

⁸ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2013.

(2+1) në katin e dytë banimi (i treti nga toka), me sipërfaqe 105 m², ku sipërfaqe apartamenti 92.5 m², i ndodhur në godinën e ndërtuar/që po ndërtohej nga kjo shoqëri sipas vendimit nr. ***, datë 10.10.2013, të Këshillit të Territorit të Komunës Kashar, me nr. *** prot., datë 29.10.2013, për të cilën është miratuar leja zhvillimore e ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimesh 1 - 7 - 9 kat + 1 kat parkim nëntokë”, në ***, në pronën e familjarëve M etj., për çmimin 48,800 euro.

24.3.1 Referuar kësaj kontrate, plani i pagesave është përcaktuar si vijon (neni 3 i kontratës): (i) vlera 44,000 euro është ekuivalente e vlerës së paguar në prenotimin e apartamentit të parë, e shoqëruar me mandate bankare; (ii) vlera e mbetur 4,800 euro do të likuidohet me marrjen e hipotekës.

24.4 Në datën 25.6.2015, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 4,800 euro, me përshkrimin “Derdhje nga Ritvan Suka, pagesë kësti për blerje banese”. Pra, rezulton se në datën 25.6.2015 është likuiduar plotësisht çmimi 48,800 euro për blerjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes datë 5.12.2013.

24.5 Në datën 27.6.2015, mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. nënshkruhet kontrata e shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi, në të cilën, ndër të tjera, përcaktohet se: “...*Kalimi i pronësisë nga shitësi tek blerësi është bërë kundrejt çmimit prej 48,800 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht...*”.

24.6 Në datën 22.9.2015, pasuria objekt vlerësimi regjistrohet në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si dhe lëshohet certifikata për vërtetim pronësie në emër të tyre, me nr. serial ***.

24.7 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie (apartamentit të ndodhur në lagjen “****”, Tiranë) mbi mënyrën e fitimit dhe pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së saj.

Verifikimet e kryera nga Komisioni mbi të ardhurat e deklaruara si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në lagjen “**”, Tiranë**

25. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit⁹, si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer: (i) kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga pagat ndër vite; (ii) kredia e marrë prej tyre në janar të vitit 2013; (iii) dhurimi i bërë nga babai.

25.1 Komisioni evidenton se me burim të ardhurat nga pagat janë kryer dy pagesa, konkretisht një pagesë e kryer në datën 22.1.2013 (vlera 15,000 euro) dhe pagesa tjetër e kryer në datën 25.6.2015 (vlera 4,800 euro). Me burim të ardhurat e përfituara nga kredia bankare është kryer pagesa në shumën 25,000 euro, në datën 7.3.2013, ndërsa me burim të ardhurat e dhuruara nga babai është kryer pagesa në shumën 4,000 euro, në datën 8.7.2013.

25.2 Për kryerjen e një analize financiare objektive, Komisioni verifikoi dhe shqyrtoi në mënyrë kronologjike të ardhurat e deklaruara si burim për kryerjen e çdo pagese deri në shlyerjen përfundimtare të çmimit total të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

Pagesa e kryer në datën 22.1.2013, në shumën 15,000 euro

26. Sikurse u evidentua më sipër, si burim për kryerjen e kësaj pagese subjekti ka referuar kursimet e tij dhe të personit të lidhur (bashkëshortes) nga pagat.

26.1 Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të depozituara në ILDKPKI dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ¹⁰ mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, Komisioni vlerëson se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditetesh *cash*, nga

⁹ Referojuni deklaramete të bëra nga subjekti në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetjes nr. 1.a) të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹⁰ Referojuni pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

deklarata fillestare e pasurisë deri në datën 31.12.2012, paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Viti	Deklaruar në DIPP/gjatë hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur					
		Valuta Lek			Valuta Euro		
		Shtesë	Pakësim	Progresive	Shtesë	Pakësim	Progresive
2008	"...kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 700,000 lekë...".	700 000	-	700 000			-
2009	"...kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 200,000 lekë...".	200 000	-	900 000			-
2010	"...kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 200,000 lekë...".	200 000	-	1 100 000			-
	"...kursime nga puna si gazetare në gazetën "***", për periudhën maj 2007 – dhjetor 2009...".	100 000	-	1 200 000	3 000		3 000
2011	"...kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 400,000 lekë...".	400 000	-	1 600 000			3 000
2012	"...kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 700,000 lekë...".	700 000		2 300 000			3 000
	Gjendja e likuiditeteve cash deri në datën 31.12.2012			2 300 000			3 000

26.2 Gjithashtu, Komisioni vëren se i pyetur më parë nga ILDKPKI-ja mbi deklaratimet e likuiditeteve *cash* ndër vite¹¹, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se deklaratimet e tij kanë qenë shtesa vit pas viti, duke zbritur vetëm pakësimin prej 15,000 euro për blerjen e apartamentit.

27. Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e referuara nga bashkëshortja e tij si burim krijimi i shumave 100,000 lekë dhe 3,000 euro, të deklaruara si kursime në gjendje likuiditetesh *cash* në DIPP-në e vitit 2010, në deklarin e bërë veçmas në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë.

28. Nga ana tjetër, bazuar në analizën paraprake të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, duket se rezultati i vitit 2008, në të cilin subjekti ka deklaruar shtesë pasurie të llojit likuiditete *cash* në shumën 700,000 lekë, paraqitet me balancë negative fondesh në vlerën prej rreth 1.2 milionë lekësh. Për rrjedhojë, Komisioni paraprakisht vlerësoi se për këtë vit subjekti nuk ka pasur mundësi të shtonte kursimet në formën e likuiditeteve *cash*. Gjithashtu, rezulton se edhe rezultati financiar i vitit 2010 paraqitet me balancë negative fondesh në vlerën prej rreth 500,000 lekësh. Sa i përket këtij viti, Komisioni paraprakisht vlerësoi se kjo balancë negative përfaqëson vlerën e likuiditeteve *cash* të deklaruara nga personi i lidhur, për të cilin subjektit iu kalua barra e provës. Ndërsa për vitet e tjera që i përkasin kësaj periudhe, në të cilat subjekti ka

¹¹ Referojuni pyetjes nr. 3 dhe përgjigjes së dhënë nga subjekti në procesverbalin "Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive", të mbajtur në ILDKPKI në datën 3.3.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.10.2023).

deklaruar shtesë likuiditetesh *cash*, rezultati i analizës financiare paraqitet me balancë pozitive fondesh. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* përgjatë viteve 2008 – 2012, në shumën prej rreth 1.5 milionë lekësh¹².

29. Por, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në seksionin përkatës burimet e krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, duket se në këtë formular ai nuk ka deklaruar pakësimin e pasurisë së llojit likuiditete *cash* të krijuara ndër vite me qëllim kryerjen e pagesës/pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apo ta referojë pakësimin e likuiditeteve *cash* si burim krijimi të kësaj pasurie. Për rrjedhojë, Komisioni paraprakisht vlerësoi se likuiditetet *cash* të akumuluar ndër vite nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

30. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në datën 22.1.2013, në shumën 15,000 euro, për likuidimin e këstit të parë të blerjes për pasurinë objekt vlerësimi, nga ku dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e kësaj pagese. Evidentuar balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 2.2 milionë lekësh.

31. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës: (i) për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e personit të lidhur, të referuara si burim krijimi për pasuritë e llojit likuiditete *cash*, të deklaruara prej saj në DIPP-në e vitit 2010, në vlerat 3,000 euro dhe 100,000 lekë, e në këtë kontekst edhe mbi rezultatet e analizës financiare të vitit 2010; (ii) mbi rezultatet e analizës financiare të vitit 2008; (iii) mbi mosdeklarimin e pakësimin të likuiditeteve *cash* në DIPP-në e vitit 2013, faktorë këta që ndikojnë në rezultatin e analizës financiare për mundësinë e kryerjes së pagesës së këstit të parë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit në lagjen “****”, Tiranë. Pra, në këtë kuptim, subjektit i kaloi barra e provës për rezultatin e analizës financiare të kryer në datën e kryerjes së kësaj pagese.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

32. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, si dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni, duke parashtruar se ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht kryerjen e pagesës në datën 22.1.2013, në shumën 15,000 euro, për likuidimin e këstit të parë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

33. Sa i përket likuiditeteve *cash* të deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2010 dhe burimit të krijimit të tyre, subjekti ka sqaruar se bashkëshortja e tij që prej vitit 2005, në momentin kur ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, dega Gjuhë-Letërsi, pranë Universitetit të Tiranës, ka punuar në profesionin e gazetarit në redaksi të ndryshme të gazetave të përditshme kombëtare. Gjatë kësaj periudhe ka punuar në gazetën kombëtare, si “****”, me botues A.H, “****”, me botues K.K, “****”, me botues Y.R, “****”, me botues F.I, “****”, me botues K.K, deri në mars të vitit 2013.

33.1 Gjithashtu, subjekti parashtron se në të njëjtën kohë që punonte në këto media bashkëshortja e tij ka punuar me honorarë në revista e gazeta të ndryshme, të cilat botoheshin në atë kohë. Por se, nga viti 2005 deri në vitin 2010 botuesit e këtyre mediave të shkruara nuk u kanë paguar punonjësve pagat konform rregullave në fuqi të kohës, përfshirë këtu edhe gazetën “****”, në periudhën maj 2007 – dhjetor 2009. Në lidhje me këtë periudhë pune, referon

¹² Diferenca e shumës 2,200,000 lekë – evidentuar si gjendje *cash* e deklaruar nga subjekti deri në datën 31.12.2012, me shumën 700,000 lekë – deklaruar si shtesë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2008, vlerësuar paraprakisht nga Komisioni në pamundësi për shtesën e kësaj pasurie.

se bashkëshortja e tij ka punuar e pasiguruar, për faj të punëdhënësve të cilët nuk kanë zbatuar ligjin.

33.2 Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti ka parashtruar se personi i lidhur për punën e kryer në gazetën “****” gjatë periudhës 2007 – 2009 është paguar me rrogë nga 40,000 deri në 50,000 lekë/muaj.

33.3 Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar disa kopje origjinale të gazetës “****”, ku evidentohen artikuj që mbajnë emrin e bashkëshortes së tij, si dhe printime nga faqja zyrtare e Bibliotekës Kombëtare, nga ku duket se në arkivin e saj shfaqen artikuj të shkruar dhe/apo intervista të gazetares E.S, për vitet 2005, 2007 dhe 2008.

34. Në lidhje me balancën negative të vitit 2008 dhe konstatimin e bërë mbi pamundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 700,000 lekë për këtë vit, subjekti ka pretenduar se një pjesë të pagës së tij që nga viti 2000 deri në vitin 2007 e ka dorëzuar/dërguar në familjen e tij prindërore. Konkretisht, referon se i ka dorëzuar në mënyrë periodike nënës të ardhura me burim pagën e tij për periudhën në fjalë, e cila i ka mbajtur së bashku me kursimet e tjera të familjes, një pjesë në banesë dhe një pjesë i ka depozituar në ish-Bankën e Kursimeve. Subjekti sqaron se nëna e tij ka administruar paratë e familjes, qoftë ato që vinin nga babai i cili ishte në emigracion, ashtu edhe pensionin dhe paratë që ai kursente nga paga e prokurorit. Në këtë kontekst, deklaroi se në pagesën e bërë për këstin e apartamentit me adresë lagjja “****”, me datë 17.3.2008, ashtu si edhe për këstet paraardhëse, pagesa të cilat janë bërë prej tij në BKT në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., me të cilën kishin lidhur kontratë porosie, kanë shërbyer paratë që mbante nëna e tij në banesë, para nga puna e babait në Itali, pensioni i pleqërisë dhe puna e tij si prokuror.

34.1 Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit kërkon që të mos përfshihet në analizën financiare të vitit 2008 pagesa e kryer në datën 17.3.2008 për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, nga shoqëria “****” sh.p.k., apartament i porositur fillimisht nga vetë subjekti, regjistruar në emër të babait të tij. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve *cash* në vitin 2008.

35. Për sa i përket konstatimit se në DIPP-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar në seksionin përkatës burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka parashtruar se gjithsesi e ka deklaruar atë në seksionin e deklarimit të detyrimeve financiare të kësaj deklarate, duke evidentuar faktin se për pagesën në shumën 15,000 euro në janar të vitit 2013 ka deklaruar si burim kursimet e tij ndër vite. Në përfundim, subjekti deklaroi se likuiditetet *cash* të kursyera prej tij dhe personit të lidhur, të akumuluar në vitet 2008 – 2012, kanë shërbyer si burim krijimi të kësaj pasurie.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

36. Në vlerësim dhe shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka punuar si gazetarë në sektorin e medias së shkruar dhe se mund të ketë përfituar të ardhura nga ky aktivitet edhe për periudhën objekt analize. Kështu, referuar provave të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, rezulton se gjatë vitit 2009 bashkëshortja e subjektit, znj. E.S, ka punuar disa artikuj në gazetën “****”, si dhe evidentohen të dhëna mbi artikuj dhe/apo intervista të marra prej saj për vitet 2005, 2007 dhe 2008 në median e shkruar. Trupi gjykues vlerëson se këto të dhëna tregojnë se subjekti nuk gjendet në kushtet e deklarimit të remë sa i përket deklarimit të punësimit dhe të ardhurave të përfituara nga puna e personit të lidhur si gazetarë, megjithëse nuk mund të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm vlerën totale të këtyre të ardhurave për periudhën para deklarimit fillestar të bërë nga bashkëshortja e tij, në cilësinë e personit të lidhur, që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive.

36.1 Trupi gjykues vëren se gjendjet e likuiditeteve *cash* të deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2010 referohen si pasuri të krijuara para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit (martesa e lidhur në prill të vitit 2010). Kështu, rezulton se në DIPP-në e vitit 2010, në deklaratën e plotësuar nga bashkëshortja e subjektit në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim, ka referuar se gjendja e likuiditeteve *cash* ka si burim punën e saj si gazetare në gazetën “****”, për periudhën maj 2007 – dhjetor 2009. Për më tepër, rezulton se në DIPP-në e vitit 2010 personi i lidhur nuk ka deklaruar të ardhura.

36.2 Në këto rrethana, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit¹³, Komisioni çmon se periudha në të cilën bashkëshortja e subjektit ka krijuar likuiditetet *cash* ka qenë përpara kohës kur personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore dhe kur ata vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Për më tepër, trupi gjykues çmon se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, të cilat janë deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve në gjendje *cash*, nga gjithë hetimi i kryer nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të saj. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit të përdorimit të një vlere monetare të krijuar me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit.

36.3 Gjithsesi, trupi gjykues çmon se të ardhurat e pretenduara nga personi i lidhur, të cilat referohen se kanë shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara prej saj në DIPP-në e vitit 2010, nuk përmbushin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare vlerat monetare të deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2010 si pasuri në gjendje likuiditetesh *cash*, konkretisht shumat 100,000 lekë dhe 3,000 euro, nuk do të reflektohen si të ardhura të mundshme, të cilat mund të kenë shërbyer si burim për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

37. Mbi prapësimet e bëra nga subjekti për rezultatin e analizës financiare të vitit 2008, të lidhura me pasurinë objekt vlerësimi sa i përket mundësisë së krijimit të likuiditeteve *cash* përgjatë këtij viti, në vlerësim tërësor dhe në harmoni të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit me deklaratimet e bëra prej tij në formularët e deklarimit të pasurive dhe interesave privatë të ILDKPKI-së, trupi gjykues krijoi bindjen se për kryerjen e pagesës në datën 17.3.2008, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë¹⁴, kanë shërbyer të ardhurat e subjektit të krijuara para vitit 2008 dhe të ardhurat e tjera të familjes së tij. Në këtë kontekst, për efekt metodologjie, në analizën financiare përfundimtare shuma 10,000 euro (konvertuar në 1,231,825 lekë) nuk do të përfshihet si shpenzim i kryer për vitin 2008, porse kjo pagesë gjithsesi do të analizohet dhe shqyrtohet në verifikimin e burimeve të deklaruara për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se kredia e marrë nga subjekti në datën 28.3.2008, në shumën 1,000,000 lekë, ka shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, konkretisht për pagesën e kështit prej 8,000 euro, në datën 31.3.2008.

37.1 Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë për vitin 2008¹⁵, nga ku konstatohet se gjithsesi ky vit paraqitet me balancë negative fondesh në vlerën prej rreth 240,000 lekësh. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi se për këtë vit subjekti ka pasur mundësi të shtonte kursimet në formën e likuiditeteve *cash*, në rastin më të mirë në shumën 460,000 lekë¹⁶.

¹³ Më specifikisht, referojuni arsyetimit të bërë nga paragrafi nr. 24 deri në paragrafin nr. 25, në vendimit nr. 19 (JR), datë 10.6.202, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për subjektin e rivlerësimit, znj. A.G.

¹⁴ Pasuri e cila do trajtohet në vijim në këtë vendim.

¹⁵ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, ndodhur në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

¹⁶ Diferenca mes vlerës së deklaruar nga subjekti si shtesë likuiditeti *cash* për këtë vit në shumën 700,000 lekë dhe vlerës së balancës negative të fondeve të evidentuar në shumën prej rreth 240,000 lekësh.

37.2 Si përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* përgjatë viteve 2008 – 2012, në shumën prej rreth 1,960,000 lekësh.

38. Komisioni vëren se subjekti i ka qëndruar deklarimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimeve të dhëna më parë në ILDKPKI, duke parashtruar se si burim për pagesën e kryer në datën 22.1.2013 ka shërbyer pakësimi i likuiditeteve *cash* të deklaruara prej tij ndër vite, duke evidentuar faktin se edhe në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar se kjo pagesë është kryer me burim kursimet ndër vite.

38.1 Lidhur me deklarimin e likuiditeteve, referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2010, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, si dhe burimin e krijimit të tyre.

38.2 Në formularët e deklarimit të pasurisë, në seksionin e emërtuar “Deklarimi i interesave privatë – pasuritë e luajtshme/pasuritë e paluajtshme” apo “Ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shitesa dhe pakësime) e ndodhura në interesat pasurorë privatë të dekluar më parë për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Si rrjedhim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte saktë ndryshimet e ndodhura të pasurisë në formë likuiditetesh *cash*.

38.3 Nga hetimi i kryer, Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e pasurive, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të pasurisë së llojit likuiditete *cash*. Por, nga ana tjetër, vërehet se në seksionin e detyrimeve financiare të kësaj deklarate, në deklarimin e bërë mbi pagesat e kryera për porositjen e apartamentit të shoqëria “****” sh.p.k., subjekti ka referuar se pagesa prej 15,000 euro ka si burim kursimet e familjes së tij ndër vite. Sjellim në vëmendje këtu se pagesa prej 15,000 euro është kryer në datën 22.1.2013. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit për periudhën 1.1.2013 – 22.1.2013 konstatohet se në total ato janë pakësuar me rreth 110,000 lekë. Nga ana tjetër, rezulton se në datën 11.1.2013 subjekti ka blerë pasurinë e llojit automjet, me vlerë 2,000 euro. Në këtë kontekst, si dhe duke ndjekur logjikën e deklarimit të subjektit, trupi gjykues krijoi bindjen se kursimet në formë likuiditetesh *cash* të deklaruara nga subjekti ndër vite kanë shërbyer si burim për pagesën e kryer në datën 22.1.2013 për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, në shumën 15,000 euro, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar specifikisht pakësimin e pasurisë së llojit likuiditete *cash*. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues është bazuar edhe në deklaratat periodike vjetore vijuese të depozituara ndër vite në ILDKPKI, duke i dhënë atyre vlerë provuese në përputhje me nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ku rezulton se subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash*.

38.4 Parë në këtë optikë, trupi gjykues çmon se për efekt të këtij procesi rëndësi merr verifikimi i mundësisë financiare të subjektit për krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash*, të cilat referohen si burim për pagesën e kësaj të parë për blerjen e apartamentit nga shoqëria “ ****” sh.p.k., duke argumentuar se pasaktësia në deklarim, e vlerësuar në raport me: (i) deklarimet e tërthorta të bëra nga subjekti në seksionin e detyrimeve të DIPP-së së vitit 2013; (ii) deklaratat e interesave periodikë vjetorë vijuese të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (iii) deklarimet e bëra deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*; si dhe (iv) shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ mbi shitesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite – nuk ndikon në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.

39. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve

financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në datën 22.1.2013, në shumën 15,000 euro, për likuidimin e kështit të parë të blerjes për pasurinë objekt vlerësimi, të pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 2

Analiza financiare për periudhën 1.1.2013 – 22.1.2013	Vlerat në lekë
A) Pasuri	312 394
Apartament banimi (në bashkëpronësi me bashkëshorten), ***, Tiranë	2 103 150
Automjet tip “****”, vit prodhimi 1999, blerë në datën 11.1.2013	280 420
Ndryshim likuiditeti	-2 071 176
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	312 394
D) Të ardhura	82 596
Të ardhura nga paga e subjektit	82 596
E) Shpenzime	17 000
Shpenzime jetese	17 000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-246 798

40. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për pagimin në datën 22.1.2013 të shumës 15,000 euro për blerjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por se në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit¹⁷ trupi gjykues konkludoi se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

40.1 Në vijim të arsytimit, trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare është relativisht e vogël në raport me investimin total të kryer nga subjekti për pasurinë objekt vlerësimi, duke pasur parasysh këtu se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson. Në këtë kontekst, duke qenë një balancë negative relativisht e ulët, si e tillë nuk arrin nivelin e cenimit të besimit të publikut dhe as nuk ngre dyshime të qenësishme mbi mundësitë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për likuidimin e çmimit të plotë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

40.2 Për më tepër, vlen të evidentohet këtu se në përlllogaritjen e vlerës së mundshme të kursimeve të disponueshme për kryerjen e kësaj pagese nuk janë reflektuar vlerat e kursimeve *cash* të pretenduara si të krijuara nga bashkëshortja e subjektit para martese, të cilat, pavarësisht se nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor, gjithsesi duket se janë proporcionale dhe të mundshme për t’u kursyer në raport me vitet e punës të deklaruara, profesionin e personit të lidhur dhe vlerat e pretenduara si paga mujore nga puna e kryer, rrethanë kjo sigurisht e vlerësuar edhe në mungesë të evidentimit të kryerjes së ndonjë investimi apo krijimi të pasurive të tjera nga personi i lidhur.

Pagesa e kryer në datën 7.3.2013, në shumën 25,000 euro

41. Sikurse u evidentua më sipër, si burim për kryerjen e kësaj pagese subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga kredia bankare e marrë në Societe Generale Albania (sot OTP Bank).

¹⁷ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 38/2021 (JR).

41.1 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje¹⁸, Komisioni konstaton se në datën 14.2.2013 është nënshkruar “Kontrata e kredisë bankare afatgjatë për shtëpi”¹⁹ mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij, në cilësinë e kredimarrësve, dhe Societe Generale Albania, në referim të së cilës banka jep te kredimarrësi një kredi në shumën 25,000 euro. Për efekt garancie për marrjen e kësaj kredie është lënë si kolateral pasuria e llojit apartament me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, regjistruar në emër të babait të subjektit, z. H.S²⁰.

41.2 Rezulton se në datë 27.2.2013 janë disbursuar fondet e kësaj kredie (shuma 25,000 euro) në llogarinë bankare të përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në Societe Generale Albania (sot OTP Bank). Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie konfirmohet se në datën 7.3.2013 shuma prej 25,000 euro është transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Pagesë kësti blerje apartamenti”.

Pagesa e kryer në datën 8.7.2013, në shumën 4,000 euro

42. Si burim për kryerjen e kësaj pagese subjekti ka referuar të ardhurat e dhuruara nga babai i tij H.S. Më specifikisht, subjekti ka deklaruar se pagesa është bërë personalisht nga babai dhe këto para kanë qenë të familjes, të cilat i ka grumbulluar gjatë viteve, dhe si burim kanë pasur punën e bërë prej tij ndër vite si emigrant jashtë vendit, nga viti 2000 deri në vitin 2010.

43. Në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. H.S bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 4,000 euro, të dhuruara në favor të subjektit, të përdorura për likuidimin e çmimit të blerjes të pasurisë objekt vlerësimi.

44. Pasi Komisioni i kërkoi subjektit që në përputhje me dispozitën e sipërcituar personi i lidhur, babai i tij, të konfirmojë dhurimin e bërë²¹, subjekti depozitoi deklaratën (shkresë e thjeshtë) e datës 29.9.2023, të babait të tij H.S, në referim të së cilës, ndër të tjera, ai deklaron se: “...Më datë 8.7.2013 ka depozituar shumën prej 4 (katër) mijë euro në Credins Bank në llogarinë e firmës “****” sh.p.k., si pagesë për këstin e radhës në bazë të kontratës së porosisë të lidhur mes djalit Ritvan Suka dhe bashkëshortes së tij E.S me këtë shoqëri. Këto para janë dhënë në formën e dhuratës për djalin Rivan Suka dhe këto të ardhura kanë qenë nga puna që ai ka bërë si emigrant në shtetin italian”.

45. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shumën 4,000 euro në seksionin e deklarimit të dhuratave dhe trajtimeve preferenciale të DIPP-së së vitit 2013. Por, nga ana tjetër, vërehet se në seksionin e deklarimit të detyrimeve financiare të kësaj deklarate, në deklarimin e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., ndër të tjera, subjekti ka referuar se është kryer edhe pagesa prej 4,000 euro nga babai H.S, në Societe Generale Albania, me burim të ardhurat e kursyera nga familja e tij.

46. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni për këtë rrethanë të konstatuar²², subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi se mosdeklarimi i kësaj dhurate, bërë nga babai, në seksionin përkatës të DIPP-së së vitit 2013, nuk ka pasur qëllim fshehjen apo mosdeklarimin e saj, pasi në të njëjtën deklaratë ajo është deklaruar në një seksion tjetër.

¹⁸ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.20121, e Societe Generale Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.1.2021; (ii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 30.6.2017, e Societe Generale Bank, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁹ Kontratë kredi bankare afatgjatë për shtëpi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2013, redaktuar nga noteri publik, z. J.Zh.

²⁰ Referojuni dokumentit “Kontratë hipotekimi” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2013, redaktuar nga noteri publik, z. J.Zh .

²¹ Pyetja/kërkesa nr. 1.c) e pyetësorit nr. ***, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

²² Pyetja nr. 1.b) e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

47. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar (ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së), si dhe dokumentacionit të depozituar prej tij bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, mbi të ardhurat e përfituara nga babai H.S si rezultat i punës së kryer në shtetin italian²³, Komisioni evidentoi se provohet me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga puna e personit të lidhur në shtetin italian për periudhën qershor 2005 – nëntor 2008, në total në shumën 61,271 euro.

48. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, ka përfituar të ardhura të ligjshme nga puna e kryer prej tij në shtetin italian për periudhën qershor 2005 – nëntor 2008, të cilat duket se mundësojnë plotësisht krijimin e shumës 4,000 euro, deklaruar si shumë e dhuruar në favor të subjektit, për kryerjen e pagesës së këstit të tretë të pasurisë objekt vlerësimi.

Pagesa e kryer në datën 25.6.2015, në shumën 4,800 euro

49. Sikurse u evidentua më sipër, si burim për kryerjen e kësaj pagese subjekti ka referuar kursimet e tij dhe të personit të lidhur (bashkëshortes) nga pagat. Në vijim të verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, sa i përket deklaramit të likuiditeteve *cash*, Komisioni konstaton se: (i) në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e deklaramit të pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat e familjes në shumën 300,000 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2014, në seksionin e deklaramit të pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar kursime nga paga vjetore në shumën 200,000 lekë.

50. Referuar deklarimeve të dhëna më parë në ILDKPKI²⁴ dhe shpjegimeve të bëra gjatë hetimit administrativ²⁵, duket se subjekti ka konfirmuar shtesat e likuiditeteve *cash* sipas pasqyrimit të bërë në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë përkatës (evidentuar si më sipër), por duke pretenduar se në fund të vitit 2014 gjendja totale e likuiditeteve *cash* ka qenë në shumën 600,000 lekë. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2015 nuk ka pasur kursime dhe i ka paguar shoqërisë “***” shumën 4,800 euro.

51. Referuar analizës së treguesve financiarë të kryer nga Komisioni²⁶, duket se rezultati i vitit 2013 paraqitet me balancë negative fondesh, ndërsa viti 2014 paraqitet me balancë pozitive fondesh. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (ku përfshihet edhe shtesa e likuiditeteve *cash*) dhe mbulimin e shpenzimeve për vitin 2013. Nga ana tjetër, gjithsesi rezulton se në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si burim pakësimin e likuiditeteve *cash* për pagesën në datën 25.6.2015, të shumës 4,800 euro.

52. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në datën 25.6.2015, në shumën 4,800 euro, për likuidimin e këstit të fundit të blerjes për pasurinë objekt vlerësimi, nga ku dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e kësaj pagese. Evidentuar balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 545,000 lekësh.

52.1 Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në funksion të dokumentimit të ligjshmërisë së të

²³ Referojuni dokumentit “Pasqyrë e llogarisë së sigurimeve shoqërore INPS”, për shtetasin H.S, i datëlindjes 23.9.1948, si dhe certifikatat CUD 2006, 2007 dhe 2009, të cilat referojnë të dhëna të punësimit të këtij shtetasit në Itali dhe mbi të ardhurat e përfituara.

²⁴ Referojuni pyetjes nr. 3 dhe përgjigjes së dhënë nga subjekti në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive” të mbajtur në ILDKPKI, në datën 3.3.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.10.2023).

²⁵ Deklarime të bëra në përgjigje të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

²⁶ Referojuni analizës përmbljedhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni dhe metodologjisë së ndjekur për realizimin e saj (aneksi nr. 1 – pjesë e këtij materiali).

ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës së kështit të fundit për likuidimin e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

53. Nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nga të gjitha kursimet *cash* të krijuara prej tij dhe bashkëshortes për vitet 2008 – 2012, në total në shumat 2,300,000 lekë dhe 3,000 euro, shuma 2,000 euro u përdor për blerjen e automjetit në datën 11.1.2013 dhe shuma prej rreth 2,103,000 lekësh (ekuivalent i vlerës 15,000 euro) u përdor për kryerjen e pagesës në datën 22.1.2013, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit.

53.1 Në këto kushte, subjekti pretendon se nga vlerat monetare të kursyera *cash* për periudhën 2008 – 2012, pas shpenzimeve të referuara më sipër i mbetën në gjendje *cash* në banesë vlerat prej rreth 197,000 lekësh dhe 1,000 euro.

53.2 Në vijim, subjekti ka parashtruar se ai dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht krijimin/shtesat e likuiditeteve *cash* të deklaruar në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2014, përkatësisht në vlerat 300,000 lekë dhe 200,000 lekë.

53.3 Në përfundim, subjekti deklaron se pagesën e kështit prej 4,800 euro ndaj shoqërisë “****” e ka bërë me paratë që ka pasur *cash* në banesë në fund të vitit 2014, si dhe nga pagat e marrë gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015.

Analiza e kryer dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

54. Komisioni vëren se në shpjegimet e dhënë në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka referuar se në fund të vitit 2014 ka disponuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 600,000 lekë. Ndërsa, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit duket se ka pretenduar një vlerë më të lartë të likuiditeteve *cash* të disponuara prej tij dhe personit të lidhur në fund të vitit 2014.

55. Bazuar në analizën financiare përfundimtare të kryer mbi mundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* për periudhën 2008 – 2012, pasqyruar në trajtimin e pagesës së kështit të parë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurisë së llojit likuiditete *cash* për këtë periudhë, në total në shumën prej rreth 1,960,000 lekësh.

55.1 Në vijim të kryerjes së analizës financiare për mundësinë e pagesës së kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, rezultoi pamundësi financiare me një balancë negative fondesh prej rreth 245,000 lekësh. Parë në këtë optikë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ketë kursime të mbartura nga likuiditetet *cash* të deklaruar më parë, pas datës së kryerjes së kësaj pagese.

56. Nga ana tjetër, në kushtet kur nga Komisioni u pranua se kryerja e pagesës për likuidimin e kështit të parë të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi ka pasur si burim pakësimin e likuiditeteve *cash*, kjo rrethanë e vlerësuar bën që analiza financiare përfundimtare e vitit 2013 të paraqitet me balancë pozitive fondesh. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht krijimin e likuiditeteve *cash* në shumën 300,000 lekë, për vitin 2013.

57. Nën dritën e këtij arsytimi, si dhe bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti në ILDKPKI, Komisioni vlerëson se në fund të vitit 2014 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi krijimi dhe kanë disponuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 500,000 lekë.

58. Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka referuar shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 4,800 euro, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e kësaj pagese.

58.1 Duke vlerësuar shpjegimet e dhëna në vazhdimësi nga subjekti mbi përdorimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në harmoni me logjikën e deklarimit të materializuar prej tij në formularët e deklarimit të pasurive dhe interesave privatë në ILDKPKI, si dhe kohën e kaluar nga krijimi/deklarimi i tyre deri në kryerjen e pagesës dhe më tej në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, trupi gjykues arrin në përfundimin se kursimet në formë likuiditetesh *cash* të krijuara për vitet 2013 dhe 2014 kanë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës së fundit për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, pagesë e kryer në datën 25.6.2015, në shumën 4,800 euro.

58.2 Pra, në arrijten e këtij konkluzioni, trupi gjykues u bazua edhe në rrethanën e konstatuar se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash*, supozuar se kjo shumë është përdorur para dorëzimit të kësaj deklarate, si dhe për faktin se nuk rezulton të jenë kryer investime të tjera nga subjekti apo personi i lidhur për këtë periudhë. Për më tepër, pas kryerjes së pagesës për likuidimin e këstit të fundit të pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni konstaton se në tetor të vitit 2015 subjekti ka marrë një kredi në shumën 500,000 lekë, deklaruar prej tij si e përdorur për mobilimin e banesës. Kjo e dhënë duket se përforcon faktin se subjekti i ka përdorur kursimet *cash* të deklaruara më parë për pagesën e kryer në qershor të vitit 2015, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit të ndodhur lagjen “****”, Tiranë.

58.3 Gjithsesi, Komisioni vlerëson se qëndron pasaktësia në deklarim, por se kjo rrethanë nuk ndikon në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.

59. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve të dhëna pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në datën 26.5.2015, në shumën 4,800 euro, për likuidimin e këstit të fundit të blerjes për pasurinë objekt vlerësimi, të pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 3

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 25.6.2015	Vlerat në lekë
A) Pasuri	242 092
Apartament banimi (në bashkëpronësi me bashkëshorten), ***, Tiranë	660 720
Ndryshim likuiditeti	-418 628
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	242 092
D) Të ardhura	737 776
Të ardhura nga paga e subjektit	737 776
E) Shpenzime	540 098
Shpenzime jetese	322 589
Shpenzime për këste kredie pranë Societe Generale Albania (OTP)	180 765
Shpenzime për kartën e kreditit pranë Credins Bank	26 421
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	10 324
Balanca e fondeve (D-C-E)	-44 414

60. Trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare është relativisht e vogël, duke pasur parasysh këtu se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson. Në këtë këndvështrim, duke qenë një balancë negative relativisht e ulët, si e tillë, nuk arrin nivelin e cenimit të besimit të publikut dhe as nuk ngre dyshime të qenësishme mbi mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për likuidimin e çmimit të plotë të blerjes

së pasurisë objekt vlerësimi. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

61. Pasuria e llojit automjet tip “**”,** blerë në datën 11.1.2013 (kontrata nr. *** rep., nr. *** kol.), në shumën 2,000 euro, me burim krijimi të ardhurat nga paga.

61.1 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2014, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar se në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2013, mbajtur përpara noteres N. Gj, ka blerë automjetin tip “****”, vit prodhimi 1999, në shumën 2,000 euro, nga shtetasi Q.V.

61.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

62. DPSHTRR-ja²⁷ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në emrin e tij automjetin me targë AA ****. Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja konstatohet se: (i) ky automjet, tip “****” (****), i regjistruar në shtetin gjerman në emër të shtetasit A.B në shkurt të vitit 2010, i është shitur shtetasit E.K; (ii) në datën 28.2.2010 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, duke u paguar detyrimi doganor, në total në shumën 363,732 lekë (duket se vlera e tij është shënuar 1,700 euro); (iii) në datën 2.3.2010, shtetasi E.B ia shet këtë automjet shtetasit Q.V, për shumën 800,000 lekë; (iv) në datën 11.1.2013, shtetasi Q.V ia shet²⁸ këtë automjet subjektit të rivlerësimit, për shumën 2,000 euro, targuar AA **** (rezulton se ky automjet më parë ka mbajtur targën TR ****); (v) pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar humbjen e targës AA **** (datë 19.5.2014), ky automjet në vijim ka marrë targën AA ****.

63. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e automjetit tip “****”, Por, gjithsesi trupi gjykues vëren se kjo pasuri me të gjithë të dhënat e saj është deklaruar në deklaratën pasardhëse të interesave private në DIPP-në e vitit 2014. Por, gjithsesi në këtë deklaratë nuk është referuar burimi i të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

64. Nga ana tjetër, rezulton se në deklarin e bërë mbi këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka referuar si burim për pagesën në datën 11.1.2013, të shumës 2,000 euro, pakësimin e likuiditeteve *cash*. Pra, duket se të ardhurat nga paga e muajit janar për vitin 2013 nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – automjetit tip “****”, blerë në datën 11.1.2013.

65. Komisioni vëren se me anë të prapësimeve të depozituara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se mosdeklarimi i saktë i të ardhurave me të cilat është krijuar kjo pasuri nuk ka pasur për qëllim fshehjen, duke theksuar se kjo pasuri është blerë me të ardhura të ligjshme, të cilat kanë si burim pagën e tij dhe të personit të lidhur.

66. Rezulton se në deklarin e bërë në DIPP-në e vitit 2014 subjekti nuk ka referuar të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie. Ndërsa, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar se kjo pasuri ka si burim të ardhurat nga pagat.

66.1 Në konsideratë të faktit se kjo pasuri nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 dhe se në DIPP-në e vitit 2014 nuk është referuar burimi i saj, Komisioni vlerëson se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë mbi burimin e të ardhurave, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, në kushtet kur rezulton se edhe kursimet e deklaruara në gjendje *cash* deri në fund të vitit 2012 kanë pasur si burim vetëm të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga pagat. Pra, për sa kohë nuk ishte deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore, mund të justifikohet fakti që subjekti nuk ka referuar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* se kjo pasuri ka pasur si burim konkret pakësimin e

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 5.2.2021, e DPSHTRR-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2021).

²⁸ Kontratë shitjeje mjete nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. N.Gj.

likuiditeteve *cash* të disponuara në fund të vitit 2012, të cilat gjithsesi kanë pasur si burim të ardhurat nga pagat e tij dhe të personit të lidhur.

66.2 Parë në këtë këndvështrim, Komisioni vlerëson se qëndron pasaktësia në deklarin e kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore, duke analizuar e shqyrtuar për efekt të këtij procesi deklarin e bërë nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* në raport me shpjegimet e dhëna me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe evidentimin e faktit se në fund të vitit 2012 subjekti ka pasur në disponim gjendje likuiditetesh *cash*, të krijuar nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësonin plotësisht kryerjen e pagesës në datën 11.1.2013, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

67. Për sa më sipër, në vlerësim përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në raport me deklarin e bëra më parë në ILDKPKI dhe dokumentacionin e administruar në dosje, trupi gjykues çmon se pasaktësia në deklarin e kësaj pasurie në vite, e pashoqëruar me mungesën e ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e saj, nuk është e mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë.

Çështje të tjera – në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë

68. Pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe totale 103.2 m², në Tiranë

68.1 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, në seksionin e deklarin të pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë sipërmarrjeje me “****” sh.p.k., për ndërtim pallati në rrugën “****”, Tiranë, me sipërfaqe 103.4 m², filluar në janar 2007, mbaron në maj 2009... Në shumën 61,900 euro, paguar me tri këste në shumën 59,000 euro, të ardhura këto të përfituara nga puna e babait prej 8 vitesh në shtetin italian”*. Ndërsa, në seksionin e detyrimeve financiare ka deklaruar: (i) kredi për pagim kësti në lidhje me sipërmarrje për blerjen e apartamentit në shumën 1,000,000 lekë; (ii) mbetur pa paguar shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 1,900 euro. Kësti i fundit prej 1,900 euro, pagesë që do të bëhet në mars të vitit 2009.

68.2 Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e deklarin të pasurive, subjekti ka deklaruar: (i) kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k., për ndërtim pallati në rrugën “****”, Tiranë, me sipërfaqe 103.4 m², filluar në janar 2007, mbaruar në maj 2009, në shumën 61,900 euro; (ii) paguar në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., shuma 1,400 euro, në datën 10.3.2009. Ndërsa, në seksionin e detyrimeve financiare ka deklaruar: *“Mbetur pa paguar firmës “****” sh.p.k., kësti i fundit në shumën 500 euro”*.

68.3 Në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: (i) paguar shoqërisë “****” sh.p.k., kësti në shumën 500 euro; (ii) kontratë pronësie mes babait H.S dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., për kalimin e pronësisë së apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, me sipërfaqe 103.4 m², në shumën 61,900 euro, filluar në janar 2007, mbaruar në maj 2009.

69. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 6.2.2007 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes²⁹ me shoqërinë “****” sh.p.k., për porositjen e apartamentit me sipërfaqe të përgjithshme 103.2 m², në objektin që po ndërtohej nga kjo shoqëri në rrugën “****”, Tiranë, për çmimin 61,900 euro. Në këtë kontratë plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) shuma 20,000 euro u likuidua nga porositësi në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) shuma 22,000 euro do të likuidohet nga porositësi brenda datës 31.10.2007; (iii) kësti i tretë prej 19,400 euro brenda datës 28.2.2008; (iv) kësti i katërt prej 500 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

69.1 Rezulton se pas deklaratës noteriale³⁰ të bërë prej subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në datën 29.10.2011 është lidhur kontrata e shitblerjes³¹ së kësaj pasurie mes babait të subjektit

²⁹ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2007, redaktuar nga noteri publik, znj. B.A.

³⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. B.A.

³¹ Kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme – apartament) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. B. A.

dhe shoqërisë, ku, ndër të tjera, përcaktohet se çmimi 61,900 euro është likuiduar mes palëve jashtë zyrës noteriale.

70. I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja mbi burimin e shumës 59,000 euro (sipas vetëdeklarimit), paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.³², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *babai i tij ka punuar prej marsit 1993 deri në dhjetor 1999 në Greqi, por pa dokumente qëndrimi. Prej gushtit të vitit 2000 deri në vitin 2010 ka punuar në shtetin italian, prej vitit 2005 deri në vitin 2010 ka qenë me leje qëndrimi... Burim tjetër kanë qenë të ardhurat nga pensioni i babait prej vitit 1993 e në vazhdim. Shton së nëna e tij ka pasur një depozitë të hapur në Bankën e Kursimeve, më vonë Raiffeisen Bank, ku ka depozituar vit pas viti pjesë nga kursimet e babait në emigrim, kjo depozitë është mbyllur në vitin 2007*³³.

71. Në përgjigje të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurash, të cilat kanë shërbyer për pagesën e shumës 61,900 euro, sa vijon: (i) të ardhurat nga puna e babait si emigrant prej 17 vitesh në shtetin grek dhe italian; (ii) të ardhurat nga pensioni i marrë prej babait nga viti 1993 deri në vitin 2009; (iii) të ardhurat nga paga e tij si prokuror, nga data 12.5.2000 deri në vitin 2008.

72. Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të depozituar lidhur me këtë pasuri, rezulton se çmimi i blerjes së saj është likuiduar si vijon: (i) shuma 20,000 euro, depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 6.2.2007; (ii) shuma 22,000 euro, depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 9.11.2007; (iii) shuma 10,000 euro, depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 17.3.2008; (iv) shuma 8,000 euro, depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 31.3.2008; (v) shuma 1,400 euro, depozituar *cash* nga babai i subjektit, z. H.S, në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 10.3.2009; (vi) shuma 500 euro, depozituar *cash* nga nëna e subjektit, znj. B.S, në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, në datën 12.10.2011.

73. Në vijim të hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. **, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit me disa pyetje dhe kërkesa³⁴, me qëllim sqarimin e rrethanave të porositjes, deklarimit, pagesave të kryera, si dhe mbi burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e këtyre pagesave në lidhje me apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

73.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2007 të kësaj pasurie nuk ka pasur qëllim fshehjen apo mosdeklarimin e kontratës së porosisë për blerjen e kësaj prone, gjë e cila provohet pasi një vit më pas ajo është deklaruar prej tij. Gjithashtu, në sqarimin e rrethanave të porositjes së kësaj pasurie, ndër të tjera, subjekti sqaron se kjo pasuri u evidentua së bashku me babain, por se kontrata u nënshkrua prej tij, pasi i ati nuk gjendej në Shqipëri në momentin e dakordësimit me shoqërinë ndërtuese për nënshkrimin e kontratës. Në vijim të sqarimeve të tij lidhur me këtë pasuri, pasi konfirmon se të gjitha pagesat e bëra në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. janë kryer nëpërmjet sistemit bankar, duke evidentuar datat dhe individët që kanë kryer pagesat (pasqyruar si më sipër), referon se si burime për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga puna e babait në emigracion për vitet 1993 – 2010; (ii) të ardhurat nga pensioni i babait; (iii) të ardhurat nga paga e tij për periudhën 2000 – 2007; (iv) kredia bankare e marrë prej tij në Raiffeisen Bank në vitin 2008.

³² Referojuni pyetjes nr. 1.b) dhe përgjigjes së dhënë nga subjekti në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, të mbajtur në ILDKPKI në datën 3.3.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.10.2023).

³³ Referon se ka depozituar nxjerrjen e llogarisë bankare depozitë në emër të nënës B.S, marrë nga Raiffeisen Bank.

³⁴ Referojuni pyetjes nr. *** të pyetësorit nr. **, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

74. Për sa më sipër, rezulton se në DIPP-në e vitit 2007 subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar porositjen e kësaj pasurie. Gjithashtu, duket se gjatë hetimit administrativ subjekti ka referuar të ardhura shtesë nga ato të deklaruara në DIPP-në e vitit 2008, si burim për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë.

74.1 Por, nga ana tjetër, rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën pasardhëse të interesave privatë, në DIPP-në e vitit 2008. Gjithashtu, konstatohet se në DIPP-të e viteve 2008, 2009 dhe 2011 subjekti ka deklaruar pagesat e kryera në funksion të likuidimit të çmimit të blerjes së kësaj pasurie, si dhe faktin e kalimit të saj në emër të babait të tij, z. H.S.

75. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti nga viti 2007 e në vijim ka deklaruar si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile dhe si adresë banimi (në dukje për vitet 2007 – 2015) adresën që lidhet me apartamentin e porositur nga shoqëria “****” sh.p.k. Në deklaratën e kontrollit të figurës “shtojca ****”, në seksionin e të dhënave të banimit, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se për periudhën mars 2009 – dhjetor 2015 ka banuar në Tiranë, në adresën lagjja “****”, rruga “****”, pallati “****”, shkalla ****, apartamenti nr. ***. Edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se kjo adresë ka qenë adresa ku ishte i regjistruar në gjendje civile, si dhe se ka banuar në këtë adresë prej muajit mars 2009 deri në vitin 2015.

76. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit në vazhdimësi ka deklaruar lidhjet e tij me këtë pasuri, qoftë duke deklaruar porositjen e saj në vitin 2008 dhe pagesat e kryera në vitet 2009 dhe 2011, po ashtu duke e referuar si adresë regjistrimi në gjendjen civile adresën e banimit të tij.

Verifikimet e kryera për të ardhurat e deklaruara si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rrugën “**”, Tiranë, mbi rrethanat e deklaruara nga subjekti për situatën e tij familjare, si dhe të dhënave të tjera të referuara në funksion të porositjes dhe likuidimit të çmimit të blerjes së kësaj pasurie**

77. Komisioni konstaton se në funksion të provueshmërisë së deklarimeve të bëra mbi qëndrimin e babait jashtë vendit në emigracion, si dhe të ardhurave të përfituara prej tij nga puna e kryer, subjekti ka depozituar dokumentet si vijon³⁵: (a) certifikatë e dhënies së vizave konsullore³⁶, datë 9.2.2022, në referim të së cilës konfirmohet se në datën 26.7.2000 Zyra Konsullore Greke në Tiranë i ka dhënë vizën nr. *** babait të subjektit të rivlerësimit, z. H S; (b) pasqyrë e llogarisë së sigurimeve shoqërore INPS³⁷ për shtetasin H.S, i datëlindjes 23.9.1948, për periudhën 6.6.2005 – 14.11.2008, si dhe certifikatat CUD 2006, 2007 dhe 2009, të cilat referojnë të dhëna të punësimit të këtij shtetasit në Itali dhe mbi të ardhurat e përfituara prej tij; (c) leje qëndrimi³⁸ në shtetin italian për shtetasin H.S, e vlefshme për periudhën 7.6.2009 – 28.12.2009; (ç) kopje e dokumentit kontratë huaje, datë 30.12.1996, me palë subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe shoqërinë tregtare “****”, në cilësinë e huamarrësit, me objekt “Dhënie hua të shumës 768,000 drahmi për një afat gjashtëmuor, me normë interesi 6% muaj”; (d) kopje e dokumentit kontratë huaje, datë 19.8.1996, me palë subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe shoqërinë tregtare “****”, në cilësinë e

³⁵ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në përgjigje të pyetësorëve të bërë nga ILDKPKI-ja, si dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

³⁶ Dokumenti “Certifikatë e dhënies së vizave konsullore”, përkthyer nga përkthyesja zyrtare e licensuar, znj. A.R, konfirmuar përkthimi me dokumentin noterial “Vërtetim përkthimi” nr. ***, datë 29.9.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. J.H.

³⁷ Dokumenti “Pasqyrë e llogarisë së sigurimeve shoqërore INPS”, përkthyer nga përkthyesja zyrtare e licensuar, znj. A.A, konfirmuar përkthimi me dokumentin noterial “Vërtetim Përkthimi” nr. ***, datë 30.9.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. A.S.

³⁸ Leje qëndrimi nr. ***, konfirmuar me dokumentin noterial “Vërtetim njësimi me originalin”, me nr. *** rep., datë 2.10.2023, redaktuar nga noteri publik, znj B.A.

huamarrësit, me objekt “Dhënie hua e shumës 200,000 lekë për një afat gjashtëmuor, me normë interesi 6% muaj”³⁹.

78. Nga verifikimi i të dhënave të përfituara nga sistemi TIMS⁴⁰, për babain e subjektit të rivlerësimit, z. H.S, konstatohet se për periudhën shkurt 2005 – dhjetor 2009 ka pasur hyrje-dalje në shtetin italian, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Dalja nga Shqipëria	Hyrja në Shqipëri	Periudha e qëndrimit në Itali/ditë qëndrimi	Periudha e qëndrimit në Shqipëri/ditë qëndrimi
20.2.2005	16.4.2006	420	
22.4.2006	24.12.2006	246	6
7.1.2007	8.8.2007	213	14
N/A	22.12.2007 ⁴¹		
5.1.2008	3.8.2008	211	14
18.8.2008	7.12.2008	111	161
17.5.2009	18.6.2009	31	24
12.7.2009	23.7.2009	11	72
3.10.2009	29.10.2009	26	34
2.12.2009	20.12.2009	18	11
	Totali	3.5 vjet jashtë vendit⁴²	

78.1 Në vijim të verifikimit të të dhënave të sistemit TIMS, Komisioni konstaton se: (i) në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë me shoqërinë “***” sh.p.k., 6.2.2007, babai i subjektit, z. H.S, nuk ka qenë në territorin shqiptar (evidentohet hyrje në datën 24.12.2006/dalje në datën 7.1.2007); (ii) në momentin e pagesës së këstit të dytë, datë 9.11.2007, duket se babai i subjektit, z. H.S, nuk ka qenë në territorin shqiptar, pasi pavarësisht se nuk është regjistruar data e tij e daljes, është konfirmuar se është kthyer në Shqipëri në datën 22.12.2007; (iii) në momentin e pagesës së këstit të tretë, datë 17.3.2008, babai i subjektit, z. H.S, nuk ka qenë në territorin shqiptar; (iv) në momentin e pagesës së këstit të katërt, datë 31.3.2008, babai i subjektit, z. H.S, nuk ka qenë në territorin shqiptar.

79. Sa më sipër, duket se ekzistojnë *indicie*/të dhëna dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se babai i subjektit, z. H.S, ka qëndruar në shtetin grek dhe atë italian dhe se mund të ketë përfituar të ardhura nga puna e tij e kryer si emigrant ekonomik në këto dy vende.

80. Por, gjithsesi, Komisioni konstaton se ai provon me dokumentacion justifikues ligjor vetëm të ardhurat e përfituara nga puna në shtetin italian⁴³ përpara likuidimit të çmimit total të blerjes së apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, për periudhën qershor 2005 – dhjetor 2008, në total shumën 61,271 euro. Të ndara sipas viteve dhe të konvertuara në lekë me kursin mesatar sipas buletinit të Bankës së Shqipërisë, vlerat përkatëse të përfituara nga babai i subjektit, z. H.S, paraqiten në tabelën si më poshtë:

³⁹ Në përmbajtje të procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 3.3.2016, mbajtur në ILDKPKI, rezulton se ndër të tjera subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “..Dua të shtoj se në vitin 2013 në Credins Bank ka tërhequr shumën 40,000 lekë si kthim i shumës prej 768,000 drahmi dhe 200,000 lekë të depozituara nga ai vetë në vitin 1996 në firmën piramidale “***”, të ardhura këto të përfituara nga puna e babait në shtetin grek. Pas falimentimit të kësaj firme dhe humbjes së shumave të sipërcituara, ai në vitin 2013 ka përfituar shumën 40,000 lekë dhe për këtë ka depozituar kontratat e huas me firmën “***””.

⁴⁰ Referuar informacionit/dokumentacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2021, të DPPSH-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.2.2021).

⁴¹ Duket se për muajin gusht të vitit 2007 është regjistruar vetëm hyrja e tij dhe jo dalja, pasi në dhjetor të vitit 2007 figuron përsëri hyrje e këtij shtetasi në territorin shqiptar.

⁴² Duket se qëndrimi në shtetin italian për këtë periudhë mund të jetë minimalisht 3.5 vjet, por se në total mund të jetë rreth 3 vjet e nëntë muaj, pasi nuk është regjistruar dalja e tij në gusht të vitit 2007 (kjo edhe në konsideratë të faktit se për vitin 2007 në dokumentin INPS referohen të dhëna për vit të plotë pune).

⁴³ Referojuni dokumentit “Pasqyrë e llogarisë së sigurimeve shoqërore INPS”, përkthyer nga përkthyesja zyrtare e licensuar, znj. A.A, konfirmuar përkthimi me dokumentin noterial “Vërtetim përkthimi” nr. ***, datë 30.9.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. A.S.

Tabela nr. 5

Viti	Vlera e të ardhurave të përfituara (në lekë)
2005	1 095 630
2006	2 221 953
2007	2 228 976
2008	1 962 667
Totali	7 509 226

80.1 Pra, rezulton se të ardhurat e konfirmuara me dokumentacion justifikues ligjor, të përfituara nga puna e babait të subjektit, z. H.S, në shtetin italian, për periudhën qershor 2005 – dhjetor 2008, janë në total në shumën prej rreth 7.5 milionë lekësh.

81. Raiffeisen Bank⁴⁴ konfirmon se nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur një depozitë të mbartur nga ish-Banka e Kursimeve, me gjendje në datën 1.10.2004 në vlerën 1,292,150 lekë. Në vijim, rezulton se kjo shumë ka vijuar të jetë e investuar në depozitë me afat pranë kësaj banke, duke përfituar edhe interesat përkatës, në vlerën totale prej rreth 151,000 lekësh, për të gjithë periudhën e investimit. Konstatohet se në datën 17.4.2007 (para pagesës së kështit të dytë për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë), nëna e subjektit ka tërhequr *cash* nga kjo llogari shumën 1,443,210 lekë.

82. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar, Raiffeisen Bank konfirmon⁴⁵ se në emër të subjektit është miratuar një kredi në shumën 1,000,000 lekë, e cila është disbursuar në datën 28.3.2008. Rezulton se në datën 28.3.2008, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është disbursuar kredia në vlerën 1,000,000 lekë dhe brenda ditës është tërhequr prej tij *cash* shuma 830,000 lekë (3 ditë para pagesës së kështit të katërt në shumën 8,000 euro, për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë).

83. Nisur nga vetëdeklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008, mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni paraprakisht vlerësoi se si burim për kryerjen e pagesave përgjatë vitit 2007 për likuidimin e çmimit të blerjes të saj mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e përfituara prej babait të tij nga puna në emigracion, ndërsa si burim për kryerjen e pagesave deri në datën 31.3.2008 mund të kenë shërbyer të ardhurat e përfituara nga puna e babait në emigracion dhe kredia bankare e marrë nga subjekti në Raiffeisen Bank.

84. Në vijim, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në shumën 42,000 euro deri në datën 9.11.2007, si dhe të pagesës në shumën 18,000 euro deri në datën 31.3.2008 (dy pagesa të tjera në vlerat 1,400 dhe 500 euro janë kryer në vitet 2009 dhe 2011), për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit në “****”, Tiranë, nga ku dukej se subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer deri në datën 31.3.2008, në total në shumën 60,000 euro, për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie. Evidentuar balanca negative e fondeve, në total në shumën prej rreth 2.6 milionë lekësh.

84.1 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, në funksion të dokumentimit të ligjshmërisë së të ardhurave financiare të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

85. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i ka qëndruar të gjitha shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, duke referuar edhe një herë se si burim krijimi për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga puna e babait në emigracion; (ii) të ardhurat nga

⁴⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2023, e Raiffeisen Bank (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.10.2023).

⁴⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.2.2021, e Raiffeisen Bank (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021).

pensioni i babait; (iii) të ardhurat nga paga e tij për periudhën 2000 – 2007; (iv) kredia e marrë prej tij në Raiffeisen Bank në vitin 2008.

Analiza e kryer dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit

86. Në shqyrtim përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe të dhënave dhe rrethanave të evidentuara lidhur me këtë pasuri: (i) deklarimit të bërë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2008 të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, dhe referimit prej tij të dy prej burimeve të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie; (ii) deklarimit të bërë nga subjekti për këtë pasuri si adresë regjistrimi në gjendjen civile dhe si adresë banimi të tij ndër vite; (iii) faktit të rezultuar se babai i tij nuk ka qenë në territorin shqiptar në momentin e nënshkrimit të kontratës së porosisë për këtë pasuri, por as në momentin e kryerjes (datat përkatëse) së katër pagesave nga subjekti; (iv) faktit të rezultuar se në vitin 2011 kjo pasuri është regjistruar në emër të babait të subjektit pas heqjes dorë nga subjekti i të drejtave reale mbi të – trupi gjykues krijoi bindjen se kemi të bëjmë me pasuri të familjes Suka, për të cilën bazuar në vetëdeklarimet e bëra kontributin më të madh në blerjen e saj e ka pasur babai i subjektit, z. H.S.

86.1 Për më tepër, nga hetimi i kryer rezultoi se kjo është pasuria e vetme e paluajtshme e krijuar nga kjo familje⁴⁶ e përdorur si shtëpi banimi e përbashkët e tyre deri në momentin që subjekti filloi të banonte apartamentin e blerë prej tij në lagjen “****”, Tiranë (krahas apartamentit të ndodhur në M, Durrës, të përfituar më parë me ligjin e privatizimit dhe të shitur në vitin 1999)⁴⁷.

87. Parë në këtë optikë, si dhe në konsideratë të faktit se subjekti i rivlerësimit deri në fund të vitit 2007 nuk ka krijuar/deklaruar pasuri⁴⁸, trupi gjykues çmon se duken të besueshme shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ se një pjesë e të ardhurave të përfituara nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë vënë në dispozicion të ekonomisë familjare, duke iu lënë në dorëzim nënës B.S, e cila në atë kohë banonte në Shkodër së bashku me vëllain e tij.

88. Në këtë kontekst, pavarësisht se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti nuk ka deklaruar specifikisht si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rrugën “****” të ardhurat nga paga e tij për vitet 2000 – 2007 dhe/apo të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë së babait, Komisioni vlerësoi se ato do të përfshihen në analizën financiare përfundimtare të kryer për evidentimin e mundësisë së subjektit dhe familjarëve të tij për blerjen e kësaj pasurie, kjo edhe në funksion të mundësisë së mbulimit të shpenzimeve.

88.1 Vlen të evidentohet këtu se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një pasuri që disponohej në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, e tillë që, për efekt të këtij procesi do të kërkonte kujdesin e shtuar të subjektit për deklarimin e të dhënave dhe burimin konkret të të ardhurave për çdo pagesë të kryer për shlyerjen e çmimit të blerjes së saj.

89. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës prej 60,000 euro deri në datën 31.3.2008 (dy pagesa të tjera në shumat 1,400 dhe 500 euro janë kryer në vitet 2009 dhe 2011 nga prindërit e subjektit), për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, të pasqyruar në tabelën më poshtë:

⁴⁶ Në familje përfshiheshin prindërit e subjektit, vëllai dhe më pas edhe bashkëshortja e tij.

⁴⁷ Shihni dokumentacionin e përcjellë me shkresën nr. **** prot., datë 10.3.2021, të ASHK-së (protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 16.3.2021).

⁴⁸ Nuk ka deklaruar as shtesa apo gjendje likuiditetesh *cash*. Evidentohet se gjendja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank në datën 31.12.2007 ka qenë me balancë negative (*overdraft*) në vlerën - 111,627.

Tabela nr. 6

Analiza financiare për periudhën 2000⁴⁹ – 31.3.2008	Vlerat në lekë
A) Pasuri	7 295 505
Apartament banimi në rrugën “***”, Tiranë.	7 295 505
B) Detyrime	1 000 000
Kredi pranë Raiffeisen Bank	1 000 000
C) Pasuri neto (A-B)	6 295 505
D) Të ardhura	12 537 605
Të ardhura nga mundësia e kursimit të subjektit	5 285 267
Të ardhura nga paga e babait të subjektit (Itali)	6 037 226
Të ardhura nga pensioni i babait të subjektit ⁵⁰	1 215 113
E) Shpenzime	4 766 487
Shpenzime jetese në Shqipëri, nëna dhe vëllai i subjektit ⁵¹	1 774 962
Shpenzime jetese në Itali, babai i subjektit ⁵²	2 991 525
Balanca e fondeve (D-C-E)	1 475 613

90. Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer deri në datën 31.3.2008, në total në shumën 60,000 euro, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit të ndodhur në rrugën “ ***”, Tiranë.

Analiza financiare për vitet 2002 – 2016⁵³

91. Bazuar në: (i) dokumentacionin e administruar në dosje; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI; (iii) shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2000 – 2003 dhe për vitet 2004 – 2016, nga ku rezulton se vitet 2008 dhe 2016 paraqiten me balancë negative të fondeve, konkretisht: (i) për vitin 2008, balanca negative e fondeve -237,950 lekë; (ii) për vitin 2016, balanca negative e fondeve -205,432 lekë. Evidentuar totali i balancës negative në shumën -443,382 lekë.

92. Në vlerësim përfundimtar të rezultatit të analizës financiare, trupi gjykues çmon se kjo balancë negative e shpërndarë në dy vite është relativisht në vlerë të vogël dhe, si e tillë, nuk është e mjaftueshme për ta vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pra, arrihet në konkluzionin se edhe kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

93. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka

⁴⁹ Komisioni ka vlerësuar që analiza e treguesve financiarë për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë të fillojë nga viti 2000, vit në të cilin subjekti ka filluar detyrën dhe evidentohen të ardhurat e para të përfituara prej tij nga paga.

⁵⁰ Të ardhurat për periudhën 2000 – 31.3.2008.

⁵¹ Pasi janë zbritur shpenzimet jetike të subjektit për periudhën në fjalë, shpenzimet e jetesës në Shqipëri janë përlogaritur për dy persona (nëna + vëllai) për periudhën 2000 – 31.3.2008.

⁵² Shpenzimet e babait në Itali janë përlogaritur për periudhën qershor 2005 – mars 2008 (periudhë në të cilën konfirmohet me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga babai i subjektit; për periudhën para marsit 2005 nuk janë reflektuar shpenzime për babain e subjektit, paraprakisht duke prezumuar se janë mbuluar me të ardhurat e tij “informale” të përfituara nga puna në emigracion.

⁵³ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës së treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, ndodhur në Aneks 1 – bashkëlidhur këtij vendimi.

deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

93.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

93.2 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

93.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

94. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

95. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

95.1 Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komision raportin⁵⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka, me konstatimet se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

96. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan H Suka.*

97. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁵⁵ për përditësimin e raportit për vlerësimin e figurës me informacione shtesë të mundshme, AKSIK-ja ka dërguar një raport të ri⁵⁶, duke arritur në konkluzionin se: *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijim të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Ritvan H Suka gjykojnë që për rastin në fjalë konkluzioni*

⁵⁴ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i AKSIK-së.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2023, e Komisionit.

⁵⁶ Raporti nr. *** prot., datë 8.5.2023, i AKSIK-së, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** , datë 10.5.2023, të KDZH-së.

të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponojë si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

97.1 Referuar këtij raporti të deklasifikuar pjesërisht, informacionet e ardhura nga institucioni i verifikimit në kohështrirje pas periudhës së rivlerësimit bëjnë me dije se për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka, disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në shpërdorim detyre dhe veprimtari të kundërligjshme.

98. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit në lidhje me përfundimet e raportit të përditësuar/ndryshuar të paraqitur nga AKSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: *“...Gjatë 24 viteve të karrierës në pozicionin e prokurorit ka ushtruar detyrën me përkushtim e profesionalizëm duke zbatuar me përpikëri ligjin. Ka treguar integritet të lartë moral e profesional duke u përpjekur maksimalisht të mbajë lartë figurën e prokurorit në sytë e publikut... Ka shmangur çdolloj komunikimi me persona apo palë të cilat mund të vinin në dyshim paanësinë në shqyrtimin e çështjeve, si dhe nuk ka frekuentuar ambiente të papërshtatshme... Ka shmangur në mënyrë kategorike çdolloj sjellje që cenon dinjitetin e palëve apo përbën shpërdorim të kompetencave apo të shpërdorimit të mjeteve, ambienteve, burimeve të institucionit për përfitime personale... Gjatë periudhës që ka punuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në detyrën e prokurorit dhe në cilësinë e zëvendës drejtuesit të prokurorisë dhe drejtuesit të seksionit “Kundër Krimeve të Rënda” ka pasur në hetim shumë çështje për vepra penale të rënda dhe me të pandehur me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilët i kanë kryer këto vepra në formën e grupeve të strukturuar kriminale. Si rezultat i hetimit të plotë të këtyre çështjeve, duke përdorur të gjitha metodat e hetimit, është bërë i mundur dokumentimi me prova ligjore të autorësisë së këtyre veprave penale dhe, për pasojë, arrestimi i shumë personave. Disa prej tyre, pasi hetimet kanë qenë të plota nga ana e tij, janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit. Po kështu, gjatë kësaj periudhe ka hetuar një sërë çështjesh penale që kanë të bëjnë me tregtimin dhe prodhimin e lëndëve narkotike, duke përdorur metoda speciale të hetimit të cilat kanë dhënë rezultat. Si rezultat i një hetimi të gjithanshëm dhe të plotë është bërë i mundur arrestimi mbi bazën e provave të shumta të pandehurve të akuzuar për kryerjen e këtyre veprave penale, të cilët më pas janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar nga gjykata me masa dënimi relativisht të larta. Për shkak të hetimit të personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur dhënien e mbrojtjes së veçantë⁵⁷, fillimisht për një periudhë 6-mujore. Mbi bazën e informacioneve të marra nga agjencitë ligjzbatuese, KLP-ja ka zgjedhur afatin për mbrojtjen e veçantë⁵⁸, mbrojtje e cila vazhdon aktualisht”.*

98.1 Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se AKSIK-ja në datën 30.6.2014 e ka pajisur me Certifikatën e Sigurisë të kategorisë C “Tepër sekret” me vlefshmëri deri më 29.6.2017. Referon se me këtë certifikatë është pajisur sërish në datën 1.7.2019, me afat vlefshmërie deri më 30.6.2024⁵⁹. Sipas subjektit, pajisja e tij me këtë certifikatë nga ky institucion tregon vlerësimin dhe besueshmërinë ndër vite.

99. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të përfituara nga agjencitë ligjzbatuese/institucionet e verifikimit.

99.1 Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfituara nga institucionet e verifikimit, Komisioni, ndër të tjera, administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së

⁵⁷ Ka referuar vendimin nr. ***, datë 31.3.2021, të KLP-së.

⁵⁸ Referon vendimet që mbajnë datat 1.10.2021, 1.4.2022, 29.9.2022, 30.3.2023 dhe 1.10.2023.

⁵⁹ Ka depozituar si prova kopjet e dy certifikatave të sigurimit të personelit të kategorisë “Tepër sekret”, të njësuara me origjinalin me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 29.11.2023, redaktuar nga noteri publik, znj. A. M.

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informacion dhe dokumentacion⁶⁰ për disa çështje penale, të referuara si të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Ritvan Suka.

99.2 Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtyre dosjeve penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo dokumentacion për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka, për aspekte që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës.

100. Komisioni ka kryer edhe verifikime të tjera në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, porse nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

101. Për më tepër, Komisioni vëren se informacionet e përcjella nga institucioni i verifikimit, mbi bazën e të cilave është përditësuar/ndryshuar raporti i AKSIK-së, nuk pasqyrojnë raste konkrete mbi të cilat mund të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe/apo përfshirja e tij në veprimtari të kundërligjshme.

101.1 Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Ritvan Suka, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

102. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

103. Subjekti i rivlerësimit, z. Ritvan Suka, në periudhën maj 2000 – mars 2008, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tropojë; në periudhën prill 2008 – maj 2023 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (në vitet 2011 – 2015 duket se ka ushtruar edhe funksionin e zv/drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan); dhe, në vijim, në periudhën qershor 2023 deri aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

104. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale – si organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore – ka përpiluar raportin për vlerësimin e aftësive profesionale (të miratuar nga KLP-ja)⁶¹ për prokurorin Ritvan Suka.

⁶⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 27.9.2023, e Komisionit dhe shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

⁶¹ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 21.11.2022.

104.1 Referuar këtij raporti, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Ritvan Suka, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe arsyetimit ligjor. Ai ka respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Rezulton se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Si konkluzion, nuk konstatohen *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit Ritvan Suka.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

105. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për vlerësimin e aftësive profesionale të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit dhe analizimit të denoncimeve të paraqitura, të disa dosjeve penale të administruara bazuar në *indiciet/informacionet* e përfituara nga institucionet e verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në këtë kuadër; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

106. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

106.1 Pas verifikimit të raportit të vlerësimit të aftësive profesionale, shqyrtimit dhe analizimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIME

Denoncimi i shtetasit A.E⁶²

107. Nga verifikimi i këtij denoncimi konstatohet se shtetasi A. E ka paraqitur ankesë kundër disa subjekteve të rivlerësimit, ndër të cilët edhe për prokurorin Ritvan Suka. Duket se ai ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda kundër disa zyrtarëve që ai i quan një grup të strukturuar kriminal (përfshirë noterë, gjyqtarë, prokurorë etj.), për shpërdorim detyre pasi, sipas tij, kanë mbështetur dhe favorizuar në kundërshtim me ligjin çiftin H (I H, noter në Shijak dhe bashkëshorten e tij L. H), me të cilin kishte një konflikt pronësie. Në pjesën ku flitet për prokurorin Ritvan Suka, denoncuesi pretendon se ka hetuar dosje me dokumente të falsifikuara, duke referuar çështjen penale nr. ***, datë 21.1.2013.

108. Komisioni administroi fashikullin e plotë⁶³ që lidhet me procedimin penal nr. ***/***, me të pandehur shtetasin A.E, akuzuar dhe gjykuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi me kredi”, parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal. Nga verifikimi i fashikullit të kësaj dosjeje penale Komisioni konstaton se:

108.1 Bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasja L.H në datën 11.4.2011, e cila pretendonte se nga ana e shtetasit A.E është konsumuar vepra penale “Shpërdorimi i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, duke referuar edhe vepra të tjera të mundshme, në datën 2.5.2011 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (përfaqësuar nga prokurorja E.M) ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

⁶² Ankesa nr. *** prot., datë 11.12.2017.

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

108.2 Në datën 6.9.2011, prokurorja M ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal nr. ***, viti 2011, për shkak të ngarkesës që kishte në hetimin/ushtimin e ndjekjes penale për një sërë procedimesh të tjera.

108.3 Në datën 12.9.2011, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka pranuar kërkesën e bërë nga prokurorja M, duke vendosur zëvendësimin e saj dhe caktimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2011, prokurorin Ritvan Suka.

108.4 Pas përfundimit të hetimeve lidhur me këtë procedim penal dhe përpilimit të aktit të njoftimit të akuzës (akt i përpiluar në datën 24.1.2012, nënshkruar nga vetë i pandehuri A.E), në datën 22.2.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka) ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2011, me të pandehur shtetasin A.E, parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal (kërkesë që i është dërguar Gjykatës me shkresën nr. *** prot./R. S., datë 24.2.2012). Rezulton se edhe në relacionin përfundimtar të përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore është sugjeruar dërgimi për gjykim i procedimit penal nr. ***/***.

108.5 Gjatë gjykimit, në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare për çështjen penale nr. ***/*** (datë 22.1.2013), prokurori Ritvan Suka ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit A.E, akuzuar për veprën penale “Mashtrimi me kredi”, parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të këtij neni të Kodit Penal, me 1 vit burgim.

108.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 15.4.2013 ka vendosur⁶⁴ deklarin fajtor të të pandehurit A.E, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi me kredi”, parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal dhe në zbatim të këtij neni, si dhe të neneve 34 e 47 të Kodit Penal, dënimin e tij me 200,000 lekë gjobë.

108.7 Pas ankimit të paraqitur nga i pandehuri, denoncuesi A.E, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur⁶⁵ lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁶⁶.

109. Sa më sipër, pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykata më e lartë. Si rrjedhim, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova për gjetje në lidhje me kriterin e vlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ritvan Suka.

Denoncimi i shtetasit A.B⁶⁷ (në dukje anonim)

110. Denoncuesi në ankesën e bërë pretendon se prokurorja E.M së bashku me prokurorin e çështjes Ritvan Suka, qëllimisht kanë zvarritur hetimin për pedagogët e arrestuar A.R, me detyrë dekan i Fakultetit të Shkencave Humane në universitetin “****”, Elbasan, dhe E.L , me detyrë shefe e Departamentit të Gazetarisë në Fakultetin e Shkencave Humane në universitetin “****”, Elbasan, që të lehtësojnë akuzat ndaj tyre dhe të pushojnë çështjen për këta dy pedagogë të akuzuar për korrupsion. Denoncuesi referon se arrestimi i tyre u krye në zbatim të vendimit nr. ***, datë 8.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka caktuar ndaj tyre masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale të parashikuara nga nenet 245/1/2 dhe 259 të Kodit Penal, “Ushtimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Në përfundim, denoncuesi hedh dyshime duke ngritur pyetjen se si ka mundësi që po ky prokuror që ka bërë arrestimin e tyre të bëjë edhe lehtësimin e akuzës ndaj tyre.

⁶⁴ Vendimi nr. ***, datë 15.4.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁶⁵ Vendimi nr. ***, datë 23.12.2014, i Gjykatës së Apelit Durrës.

⁶⁶ Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 23.12.2014.

⁶⁷ Ankesë e përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.11.2020).

111. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁶⁸, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se⁶⁹ ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 20.9.2017, i cili në datën 2.10.2017 është bashkuar me procedimin nr. ***/*** dhe në datën 12.7.2018 është bashkuar me procedimin nr. ***/***, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, ndër të tjerë me persona nën hetim shtetasit A.R dhe E.L. Në datën 19.9.2019, prokurori i çështjes Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesë për pushim akuze ndaj shtetasve A.R dhe E.L.

112. Më konkretisht, pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikujve të kësaj dosjeje penale, Komisioni konstaton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialeve të administruara nga procedimi penal nr. ***, viti 2017, të regjistruar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv dhe mbajtje pa leje të lëndës plasëse”, parashikuar nga nenet 152 e 278/1 të Kodit Penal, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2017, për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. C.

112.1 Gjatë hetimit të procedimit penal nr. ***, viti 2017, nëpërmjet metodave speciale të hetimit është realizuar vënia në përgjim e disa numrave telefonikë celularë, me qëllim identifikimin e autorëve të ngjarjes, për të cilën ishte regjistruar ky procedim penal. Pas identifikimit të një prej autorëve të dyshuar (shtetasit P. K.) nga policia gjyqësore është kërkuar dhe, në vijim, realizuar vëzhgimi i këtij shtetasi, me qëllim identifikimin e tij dhe të personave të tjerë me të cilët ky shtetas ka kontakte, pasi nga përgjimet rezultonte se ky shtetas luante rolin e ndërmjetësit mes studentëve, personave të ndryshëm që kishin qëllim sigurimin e ndërmjetësit për marrjen e notave kaluese nga pedagogë të ndryshëm të universitetit “****”.

112.2 Në datën 29.9.2017, në bazë të informacioneve të marra në rrugë të ligjshme, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2017, për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 në ngarkim të të pandehurit P. K.

113. Në datën 2.10.2017, procedimi penal nr. *** është bashkuar me procedimin penal nr. ***, viti 2017, në një procedim të vetëm me nr. ***, pasi personi ndaj të cilit po zhvilloheshin hetime ishte shtetasi P. K., i cili dyshohet të ketë kryer të njëjtën vepër penale, atë të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

113.1 Nga transkripti i bisedave telefonike të përgjuara nga numri telefonik i personit nën hetim P. K. rezultoi se ky shtetas ka komunikuar me numrin telefonik, i cili përdorej nga shtetasja e identifikuar nga ana e policisë gjyqësore si E.L, me detyrë shefe e Departamentit Letërsi - Gazetari dhe me numrin telefonik, i cili përdorej nga shtetasi i identifikuar nga policia gjyqësore si A.R, me detyrë dekan i Fakultetit të Shkencave Humane në universitetin “****”, Elbasan.

113.2 Nga transkriptet e bisedave të përgjuara në lidhje me numrat e përdorur nga shtetasit M.C., P. K., E.L, A.R, A. N. dhe E. C. rezultonte se kishte dyshime të arsyeshme se këta shtetas mund të kishin konsumuar veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

114. Në datën 2.7.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. *** mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan që bën fjalë për kallëzimin e shtetasit E. Sh., i cili ka qenë student në fakultetin Cikli i Ulët në Universitetin e Elbasanit. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. ***, për shkak se denoncohej i njëjti subjekt, personi nën hetim/i pandehuri P. K.

114.1 Në funksion të këtij procedimi, prokurori Ritvan Suka kë kërkuar edhe ndalimin e shtetasve A.R dhe E.L dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tyre “Arrest në burg”. Duket se krahas përgjimeve telefonike dhe vëzhgimeve të realizuara janë kryer disa sekuestre

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2023, e Komisionit.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

provash materiale, të cilat janë vleftësuar nga prokurori Ritvan Suka, janë autorizuar kontrolle banesash dhe zyrash të personave, si dhe është kërkuar ekspertimi i disa pajisjeve telefonike të sekuestruara etj.

115. Nga verifikimi i akteve të këtij procedimi penal duket se në vazhdimësi prokurori Ritvan Suka ka kundërshtuar kërkesat e bëra nga personat nën hetim (ku përfshihen edhe E.L dhe A.R) dhe/apo vendimet e gjykatave për të lehtësuar masën e sigurimit personal ndaj tyre.

115.1 Gjatë kësaj kohe prokurori Ritvan Suka ka kërkuar disa herë zgjatjen e afateve të hetimit, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore shtesë dhe/apo kryerjen e plotë të transkripteve të bisedave telefonike të përgjuara, administrimin e akteve të ekspertimit të kërkuara etj.

116. Rezulton se në datën 6.9.2019, prokurori Ritvan Suka ka njoftuar personat nën hetim A.R dhe E.L për përfundimin e hetimeve. Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, në datën 19.9.2019, prokurori Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me dy kërkesa:

116.1 Kërkesën për: (i) pushimin e hetimeve për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksionet publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal, në ngarkim të personave nën hetim A.R, E.L, E. C., A. N. dhe A. K., në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2017; (ii) shuarjen e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur”, parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal në lidhje me personat nën hetim A.R, E.L, E. C., A. N. dhe A. K. Rezulton se në kërkesën për pushimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit, pasi ka referuar rrethanat e çështjes, veprimet hetimore të kryera gjatë hetimit dhe provat e siguruara, ka argumentuar se nuk u provua që personat nën hetim A R, E.L, E. C., A. N. dhe A. K. të kenë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 245/1, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal.

116.2 Kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***, viti 2017, me të pandehur shtetasit P. K., i akuzuar sipas nenit 245/1, paragrafi 2, dhe M. C., i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 1 i Kodit Penal.

117. Duket se në shënimet e bëra nga sekretaria në seksionin “Vendimet e Gjykatës” – te kapaku i dosjes së fashikullit të këtij procedimi penal referohet se janë deklaruar fajtorë nga gjykata të pandehurit P. K. dhe M. C.

118. Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kërkoi të konfirmojë nëse është pranuar/miratur nga gjykata kërkesa e tij për pushimin e hetimeve për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksionet publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal, në ngarkim të personave nën hetim A.R, E.L, E. C., A. N. dhe A. K., në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2017, duke depozituar kopje të njësuar me origjinalin të vendimit të gjykatës.

118.1 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti ka konfirmuar se kërkesa për dërgimin në gjyq të kësaj çështjeje ndaj shtetasve P. K. dhe M. C., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 245/2 e 245/1 të Kodit Penal dhe kërkesa për pushimin e çështjes ndaj shtetasve E.L, A.R, E. C., A. N. dhe A. K. janë pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (vendim i cili ka marrë formë të prerë).

119. Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat. Si rrjedhim, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova për gjetje në lidhje me kriterin e vlerësimit në aspektin etiko - profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ritvan Suka. Për më tepër, Komisioni vëren se nuk evidentohet pozicioni i denoncuesit në lidhje me këtë dosje penale.

Denoncimi i shtetasit I.F⁷⁰

120. Denoncuesi pretendon se prokurori Ritvan Suka, me veprimet e bëra me dashje dhe të drejtpërdrejta, ka akuzuar dhe ka arrestuar djalin e tij që nga data 8.10.2018. Sipas denoncuesit, organi i akuzës që ka ndjekur hetimet (prokurori Ritvan Suka) nuk ka prova që të vërtetonte se personi nën hetim I.F ka kryer veprën penale “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim.

121. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁷¹ për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjes së procedimit penal, ku si person nën hetim/i pandehur shfaqet shtetasi I.F, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se⁷² ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 8.10.2018, për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal, ndër të tjerë, me të pandehur shtetasin I.F . Në datën 7.10.2019, prokurori i çështjes Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Me vendimin e datës 29.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar fajtor. Më konkretisht, pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të kësaj dosjeje penale, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se:

121.1 Në datën 8.10.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka) ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtje pa leje e armëve të zjarrit” në ambiente publike, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 e 287/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve S (B) H dhe I.F për ngjarjen e ndodhur po në datën 8.10.2018, në vendin e quajtur Kryqëzimi***, në rrugën *** – ***, ku janë plagosur me armë zjarri shtetasit G.K dhe J. R.

121.2 Pas ndalimit dhe arrestimit të dy personave nën hetim, S.H dhe I.F, prokurori Ritvan Suka, në datën 11.10.2018, ka dërguar në gjykatë kërkesën⁷³ për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj tyre.

121.3 Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, në datën 12.10.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur⁷⁴: (i) të vleftësojë të ligjshëm arrestin në flagrancë kundër personit nën hetim S.H; (ii) t’i caktojë personit nën hetim S.H masën e sigurimit personal “Arrest në burg”; (iii) të vleftësojë të ligjshëm arrestin në flagrancë kundër personit nën hetim I.F; (iv) t’i caktojë personit nën hetim I.F masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, me afat 40 ditë⁷⁵.

121.4 Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka), duke kërkuar⁷⁶ ndryshimin e tij në këtë mënyrë: “Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” pa afat, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me personin e arrestuar I. F”.

121.5 Në datën 31.10.2018, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: (i) miratimin e vendimit nr. ***/***, datë 12.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për sa i përket vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit I.F; (ii) caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për personin nën hetim I.F.

121.6 Në datën 13.12.2018, personi nën hetim I.F (përfaqësuar nga av. I. M) ka paraqitur kërkesën me objekt verifikimin e nevojave të sigurimit, duke kërkuar caktimin e një mase

⁷⁰ Ankesë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2023, e Komisionit.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komisionin me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

⁷³ Kërkesa për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2018.

⁷⁴ Vendimi nr. *** (***), datë 12.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁷⁵ Rezulton se në datën 18.10.2018, prokurori Ritvan Suka ka përpiluar urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, dërguar me shkresë Komisarariatit të Policisë Cërrik, për OPGJ-në A.S (shkresa nr. *** prot., datë 23.10.2018, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan).

⁷⁶ Kërkesë e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, të Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

sigurimi më të butë e, konkretisht, zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

121.7 Në datën 27.12.2018, prokurori Ritvan Suka ka përpiluar informacion drejtuar gjyqtarit të hetimeve paraprake, duke evidentuar rrethanat që, sipas tij, tregojnë se duhet rrëzuar kërkesa e bërë për ndryshimin e masës së sigurimit dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me personin nën hetim I.F.

121.8 Në datën 28.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur⁷⁷ pushimin e gjykimit në lidhje me kërkesën për verifikimin e nevojave të sigurimit, duke kërkuar caktimin e një mase sigurimi më të butë për personin nën hetim I.F , pasi avokati i personit nën hetim hoqi dorë nga shqyrtimi i kërkesës objekt gjykimi.

121.9 Në datën 24.1.2019, personi nën hetim I.F (përfaqësuar nga av. I.M) ka paraqitur sërish në Gjykatë kërkesën me objekt verifikimin e nevojave të sigurimit, duke kërkuar caktimin e një mase sigurimi më të butë e, konkretisht, zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

121.10 Edhe në lidhje më këtë kërkesë, prokurori Ritvan Suka ka përpiluar informacion (i cili duket se mban datën 20.2.2019) drejtuar gjyqtarit të hetimeve paraprake, duke evidentuar rrethanat të cilat, sipas tij, tregojnë se duhet rrëzuar kërkesa e bërë për ndryshimin e masës së sigurimit dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me personin nën hetim I.F .

121.11 Në datën 1.3.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur⁷⁸ rrëzimin e kërkesës së bërë nga personi nën hetim I.F , për verifikimin e nevojave të sigurimit, duke kërkuar caktimin e një mase sigurimi më të butë. Sikurse u evidentua edhe më sipër, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, qëndrim i mbajtur prej tij edhe në seancë gjyqësore.

121.12 Prokurori Ritvan Suka ka përpiluar disa vendime për zgjatjen e afatit të hetimit që mbajnë datat 8.1.2019, 28.4.2019 dhe 8.7.2019. Me vendimet e datave 8.4.2019 dhe 8.7.2019 duket se janë njohur personat nën hetim dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë (pasi duket se kanë nënshkruar në to), ndërsa sa i përket vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 8.1.2019, duket se nuk provohet njoftimi i personave nën hetim dhe/apo përfaqësuesve të tyre ligjorë.

122. Pra, duket se vendimi i datës 8.1.2019 për zgjatjen e afatit të hetimit nuk i është njoftuar personave nën hetim, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se: “*Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve i njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit*”⁷⁹. Në këtë kontekst, në rast të mosnjoftimit të zgjatjes së afatit të hetimit, referuar nenit 325 të Kodit të Procedurës Penale, duket se personave nën hetim u është mohuar e drejta që brenda 10 ditëve nga njoftimi të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

122.1 Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës në lidhje me këtë konstatim, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka parashtruar duke konfirmuar se “Vendimi për zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake” datë 8.1.2019, i është njoftuar personave nën hetim, të cilët në atë kohë ndodheshin në dhomat e paraburgimit të IEVP-së Elbasan. Subjekti ka evidentuar se ky njoftim është bërë nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 29.1.2019, drejtuar IEVP-së Elbasan. Në vijim, subjekti ka argumentuar se shtetasit I.F dhe S (B) H kanë marrë njoftim nëpërmjet kësaj shkrese dhe atyre nga momenti i marrjes njoftim u ka lindur e drejta për ta ankimuar në këtë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka depozituar si prova dokumentet: (i) shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2019, të Prokurorisë së Rrethit Elbasan; (ii) vendimin për zgjatjen e hetimeve të datës

⁷⁷ Vendimi nr. ***(***) , datë 28.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁷⁸ Vendimi nr. ***(***) , datë 1.3.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁷⁹ Në nenin 34/a, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe*”.

8.1.2019; (iii) fletën e regjistrit të korrespondencës së vitit 2019 të administruar nga Sekretaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në të cilën rezulton se në faqen “dokumente të dala”, që i përket datës 29.1.2019, është shënuar shkresa nr. *** prot., drejtuar IEVP-së Elbasan, me objekt “Vendim zgjatjeje hetimi S. H etj.”.

123. Në vijim të verifikimit të materialeve të kësaj dosjeje penale rezulton se në datën 23.9.2019, pasi më parë e ka njoftuar për përfundimin e hetimeve, prokurori Ritvan Suka ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit personin nën hetim I.F , duke e akuzuar për veprën penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal, vendim me të cilin duket se është njoftuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

124. Në datën 7.10.2019, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. **, viti 2019, me të pandehur shtetasin S.H , akuzuar sipas neneve 76 e 22 dhe 25, si dhe 278/1 të Kodit Penal dhe shtetasin I.F , akuzuar sipas neneve 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal, duke përpiluar kërkesën përkatëse drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

125. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 6.11.2019 ka vendosur⁸⁰: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Dërgimin për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (seksioni penal) të procedimit penal nr. **, datë regjistrimi 8.10.2019, në ngarkim të të pandehurit S (B) H, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, në bashkëpunim, dhe “Mbajtje pa leje e armëve të zjarrit në ambiente publike”, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 dhe 278/1 të Kodit Penal, si dhe shtetasit I.F , i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” të mbetur në tentativë, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal; Dërgimin e kërkesës së të pandehurit S (B) H për të proceduar me gjykim të shkurtuar”.

126. Në përfundim të gjykimit të procedimit penal nr. **, viti 2018, në “Konkluzionet përfundimtare” (datë 16.7.2020) prokurori Ritvan Suka ka kërkuar: (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit S (B) H, për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe në bazë të dispozitës së këtij neni dënimin e tij me 12 vjet burgim; (ii) Deklarimin fajtor të të pandehurit S (B) H, për kryerjen e veprës penale “Mbajtje pa leje e armëve të zjarrit në ambiente publike”, parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 4 vjet burgim; (iii) Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe përfundimisht dënimin e të pandehurit me 14 vjet burgim; (iv) Deklarimin fajtor të të pandehurit I.F për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe në bazë të dispozitës së këtij neni dënimin e tij me 12 vjet burgim.

127. Sikurse është referuar në shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan i ka deklaruar fajtorë këta dy të pandehur.

128. Si konkluzion, pas shqyrtimit në tërësi të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues vëren se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë kryesisht me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë bërë/janë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat. Nga Komisioni nuk u vërejtën fakte apo rrethana të tjera që mund të përbëjnë prova për gjetje në lidhje me kriterin e vlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ritvan Suka.

Denoncimi i shtetasit I.Sh⁸¹

129. Denoncuesi pretendon se prokurori Ritvan Suka në shkelje të ligjit dhe duke përdorur metoda të paligjshme e ka manipuluar e mashtruar për t’i marrë ADN-në, për të futur në kurth djalin e tij F.Sh. Denoncuesi referon se *prokurori Ritvan Suka e ka thërritur në zyrën e tij në*

⁸⁰ Vendimi nr. ** (**), datë 6.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁸¹ Ankesë nr. ** prot., datë 1.2.2021.

*Prokurorinë e Rrethit Elbasan dhe i ka thënë se djali i tij është arrestuar në Gjermani sepse kishte përdhunuar një rumune dhe që ky prokuror të nxirrte djalin i duhej ADN-ja e tij, që ta krahasonin me gjurmët e spermës që, sipas prokurorit, ishin gjetur te rumunia e përdhunuar. Denoncuesi deklaroi se në momentin e parë u shokua, pasi sipas tij e dinte që djali nuk bënte gjëra të tilla, por prokurorit iu duk i besueshëm, se gjasme po i qante hallin, dhe pranoi t'i jap ADN-në, pasi sipas prokurorit ishte mënyra e vetme që djali të dilte nga burgu në Gjermani. Më pas denoncuesi referon se ka parë në lajme dhe portale që analiza e ADN-së që i është bërë atij ka qenë vendimtare për zbardhjen e vrasjes së shtetasit R.R, ngjarje kjo e ndodhur më 29.7.2009, në lagjen “****”, Elbasan. Denoncuesi pretendon se djali i tij është arrestuar në Gjermani 12 vjet pas ndodhjes së ngjarjes së sipërcituar, pas sajësive të bëra qëllimisht nga prokurori Ritvan Suka me ADN-në, për të bërë bujë dhe për t'i bërë presion familjes së tij. Referon se ka pasur edhe nxjerrje të sekretit hetimor, duke pretenduar se ky informacion është nxjerrë qëllimisht nga prokurori Ritvan Suka. Pra, denoncuesi pretendon se metodat që ka përdorur ky prokuror në hetimin e kësaj çështjeje nuk janë etike, janë në kundërshtim me ligjin dhe janë tipike si metodat e hetuesisë së diktaturës. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se oficeri, i quajtur S.Zh apo Sh, pas kontrollit të bërë në shtëpinë e tij me porosi të prokurorit Ritvan Suka, i tha që t'i mbushë mendjen djalit të bashkëpunojë, që të dali për 2 vjet e të thotë që ka qenë i porositur nga fisi Ç. Denoncuesi hedh dyshime se prokurori Ritvan Suka ka akuzuar qëllimisht djalin e tij duke mbushur media e portale me gënjeshtër, duke dashur “t'i bëj gropën” padrejtësisht për të arritur qëllimet e veta.*

130. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁸² për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjes së procedimit penal ku, si person nën hetim shfaqet shtetasi F.Sh, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se⁸³ ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 23.7.2009, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/1 e 25 dhe 27/2 të Kodit Penal, me person nën hetim shtetasin F. Sh. Në datën 20.9.2010, prokurori i çështjes Ritvan Suka ka vendosur pezullimin e hetimeve. Me vendimin e datës 22.7.2021, prokurori i çështjes ka vendosur rifillimin e hetimeve për procedimin nr. ***. Në datën 7.4.2023 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Më konkretisht, pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të kësaj dosjeje penale, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se:

130.1 Në datën 22.7.2009 është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2009, për veprat penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” të parashikuara nga nenet 78 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal, në lidhje me ngjarjen e ndodhur po në datën 22.7.2009, në lagjen “****”, Elbasan, ku si pasojë ka gjetur vdekjen, vlarë me armë zjarri, shtetasi R.R.

130.1.1 Nga hetimet e kryera rezultoi se shtetasit A.Ll dhe M.T në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe persona të tjerë të kenë kryer veprën penale “Vrasje me paramendim” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal.

130.2 Në datën 16.7.2010, bazuar në nenin 93/1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, procedimi penal nr. *** u nda në procedimin penal nr. *** në ngarkim të të pandehurve A. Ll dhe M.T, të akuzuar përkatësisht nga nenet 78 e 25 dhe 278/2, duke kaluar çështjen për gjykim në ngarkim të tyre⁸⁴ dhe në procedimin penal nr. ***, viti 2009, me qëllim vazhdimin e hetimeve për zbulimin e autorëve të tjerë të kësaj ngjarjeje.

130.3 Në datën 20.9.2010, procedimi penal nr. ***, viti 2009, është pezulluar pasi nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve të tjerë të kësaj ngjarjeje dhe aktet e këtij procedimi penal i kanë kaluar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan (vlen të përmendet se janë siguruar disa

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2023, e Komisionit.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

⁸⁴ Rezulton se këta dy shtetas janë gjykuar dhe janë dënuar për kryerjen e kësaj vepre penale.

profile gjenetike “të paidentifikuara”, të përfituara nga provat e administruara në funksion të hetimeve të kryera).

130.4 Në datën 22.7.2021, mbi bazë të relacionit të datës 19.7.2021, ardhur nga Departamenti i Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është vendosur rifillimi i hetimeve në lidhje me këtë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga nenet 78 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal.

130.4.1 Sipas këtij informacioni, nga ana e policisë është bërë i mundur identifikimi i disa personave me lidhje shoqërore të ngushta me të dënuarit për këto vepra penale, të cilët nuk ka qenë e mundur të identifikoheshin në momentin e ndodhjes së kësaj ngjarjeje, për të cilat është i nevojshëm krahasimi i gjurmëve daktiloskopike dhe krahasimi biologjik ADN në lidhje me provat materiale.

130.4.2 Për këtë arsye, me qëllim kryerjen e këtyre veprimeve për identifikimin e autorëve, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se këta persona në lidhje shoqërore me të pandehurit mund të kenë bashkëpunuar në kryerjen e vrasjes së shtetasit R.R., është vendosur rifillimi i hetimeve.

130.5 Pas rifillimit të hetimeve në datën 22.7.2021, nga ana e policisë gjyqësore është marrë informacion se një nga profilet gjenetike të gjetur në ngjarjen ku është vrarë shtetasi R.R është identifikuar nga autoritetet gjermane, pasi më parë nga ana e Departamentit të Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Tiranë u janë dërguar zyrtarisht homologe nëpërmjet Interpol Tirana profilet e ADN-së të administruara, por të paidentifikuara me qëllim identifikimin e tyre dhe zbulimin e ngjarjeve të ndryshme kriminale.

130.5.1 Nga përgjigjja e ardhur prej autoriteteve gjermane është arritur të identifikohet një prej profileve të ADN-së të pazbuluara në ngjarjen ku është vrarë shtetasi R.R. Në bazë të këtij informacioni autoritetet gjermane konfirmojnë se një nga këto profile i përket shtetasit shqiptar F.I.Sh, i datëlindjes 29.1.1982.

130.5.2 Pas korrespondencës së mbajtur me autoritetet gjermane rezultoi se shtetasi F Sh ndodhej i paraburgosur në këtë shtet, i akuzuar për veprën penale “Kryerje e marrëdhënieve seksuale me dhunë”.

130.6 Duket se nga ana e Prokurorisë (prokurorit Ritvan Suka) është identifikuar babai i këtij shtetasi I.Sh dhe në datën 1.9.2021 ai është thirrur me qëllim pyetjen në cilësinë e personit që jep të dhëna në lidhje me hetimin. Në kushtet kur personi i dyshuar ndodhej jashtë vendit dhe në gjendje arresti, Prokuroria ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit biologjik krahasues nëpërmjet ADN-së së profilit gjenetik të shtetasit I.Sh dhe profileve të gjetura dhe të sekuestruara në ngjarjen e vrasjes së shtetasit R.R.

130.6.1 Në bazë të aktit të ekspertimit biologjik krahasues ADN nr. ***, datë 8.9.2021, rezulton se nga mostrat e përgatitura nga kampionet pështymë model krahasimi, marrë me dy tamponë shtetasit I.Sh, u përftua një profil gjenetik human i plotë i seksit mashkull me karakteristikat e përshkruara. Profili gjenetik i përftuar në kampionët pështymë të shtetasit I.Sh paraqet lidhje gjenetike babë-bir me profilin gjenetik të përftuar nga bishti i cigares nr. *** dhe një njollë gjaku me nr. ***, prova të administruara në dosjen penale që lidhen me ngjarjen e vrasjes së shtetasit R.R.

130.7 Si rrjedhim, nga veprimet e kryera në lidhje me këtë procedim penal është konkluduar se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personi nën hetim F.Sh ka konsumuar veprat penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga nenet 78 e 25 të Kodit Penal, dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

130.8 Në datën 10.9.2021, prokurori Ritvan Suka ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale e, më konkretisht, ka urdhëruar që në regjistrin e njoftimit të veprave penale në kolonën përkatëse për procedimin penal nr. ***, viti 2009, të shënohet emri i shtetasit F.Sh, dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar

nga nenet 78 e 25 të Kodit Penal, dhe “Prodhimi dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

130.9 Po në datën 10.9.2021, prokurori Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga nenet 232/dh dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit F. Sh, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga nenet 78 e 25 të Kodit Penal, dhe “Prodhimi dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

130.10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 11.9.2021 ka vendosur⁸⁵ pranimin e kërkesës së Prokurorisë, duke caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim F.Sh.

130.11 Në vijim, duket se është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar e këtij shtetasi dhe pasi janë kryer procedurat e ekstradimit, në datën 11.1.2022 është mbajtur procesverbali për ekzekutimin e vendimit penal nr. ***, datë 11.9.2021, për shtetasin F.Sh.

130.12 Në datën 23.3.2023, prokurori Ritvan Suka ka përpiluar “Njoftimin për përfundimin e hetimeve”, njoftimi i cili duket se i është dorëzuar të pandehurit F.Sh në datën 31.3.2023. Pra, duket se i pandehuri F.Sh ka marrë dijeni për përfundimin e hetimeve në datën 31.3.2023.

130.13 Sikurse është referuar në shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në datën 7.4.2023 prokurori Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim, duke kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***, viti 2009, me të pandehur shtetasin F.Sh, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 78/1 e 25 të Kodit Penal. Po në datën 7.4.2023, prokurori Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesën për pushimin e çështjes penale për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit F.Sh, në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2009.

131. Në vijim të verifikimit të materialeve të kësaj dosjeje rezulton se në datën 10.1.2023, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar nga Gjykata zgjatjen e afateve të paraburgimit me tre muaj, duke argumentuar se ka nevojë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore – kërkesë e pranuar nga Gjykata, e cila ka disponuar me vendimin nr. *** (***) datë 11.1.2023. Pas ankimit të bërë mbi këtë vendim nga personi nën hetim F.Sh, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit⁸⁶.

132. Gjithashtu, rezulton se prokurori Ritvan Suka ka vendosur disa herë për zgjatjen e afateve të hetimit, duke argumentuar se është e nevojshme kryerja e disa veprimeve hetimore, administrimi i disa provave dhe kryerja e veprimeve procedurale në lidhje me përfundimin e hetimeve dhe njoftimin e akuzës (vendimet e datave 10.12.2021, 10.3.2022, 10.6.2022, 9.9.2022, 9.12.2022 dhe 10.3.2023).

132.1 Por, duket se këto vendime nuk i janë njoftuar në kohë personit nën hetim F.Sh , në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se *vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve i njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit*⁸⁷. Duket se në të gjitha vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit personi nën hetim F.Sh ka bërë shënimin me shkrim të lirë dore: “*U njoha me zgjatjen e hetimeve sot datë 31.3.2023*”. Në këtë kontekst, në rast të mosnjoftimit të zgjatjes së afatit të hetimit, referuar nenit 325 të Kodit të Procedurës Penale, duket se personit nën hetim i është mohuar e drejta që brenda 10 ditëve nga njoftimi të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

⁸⁵ Vendimi nr. *** (***) datë 11.9.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁸⁶ Vendim nr. ***, datë 20.2.2023, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁸⁷ Në nenin 34/a, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe*”.

132.2 Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës në lidhje me këtë konstatim, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka parashtruar: “...Në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2009, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë rifilluar hetimet bazuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale. Pas rifillimit të hetimeve dhe kryerjes së një sërë veprimesh hetimore në datën 10.9.2021 është regjistruar emri i personit nën hetim, shtetasit F. Sh , për veprat penale të parashikuara nga nenet 78, 25 e 278/2 të Kodit Penal. Në datën 11.9.2021, pas kërkesës së bërë nga ana e Prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin nr. *** ka vendosur masën e sigurimit “Arrest me burg” në mungesë parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, në ngarkim të shtetasit F.Sh. Ekzekutimi i masës së sigurimit “Arrest me burg” në mungesë është bërë pas kryerjes së procedurave të ekstradimit të shtetasit F.Sh nga shteti gjerman në datën 11.1.2022. Në këto kushte, duke qenë se shtetasi F.Sh ka qenë në mungesë, vendimi për zgjatjen e hetimeve i datës 10.12.2021 nuk është bërë e mundur t’i njoftohet këtij shtetasi në datën 10.12.2021, pasi ai ka qenë i ndaluar në shtetin gjerman për efekt të ekstradimit në lidhje me këtë çështje penale”.

132.3 Komisioni vëren se në vijim të prapësimeve të tij subjekti ka shpjeguar se i pandehuri F.Sh është njoftuar me vendimet e zgjatjeve të afateve në fundin e hetimeve të këtij procedimi penal dhe në këtë moment atij i ka lindur e drejta për t’u ankuar brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit ndaj këtyre vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve. Subjekti referon se nga verifikimet e bëra në sistemin ICMIS të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se as i pandehuri dhe as avokati i tij mbrojtës nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë për kundërshtimin e vendimeve të zgjatjes së afateve të hetimit⁸⁸. Pra, subjekti argumenton se gjithësesi të pandehurit F.Sh nuk i është mohuar e drejta për të ushtruar ankim.

132.4 Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se qëndron konstatimi i bërë mbi mosnjoftimin në kohë personin nën hetim të vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Por, në kushtet kur gjithësesi ka rezultuar se personit nën hetim i janë njoftuar të gjitha vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit, vlerësuar si një rrethanë që nuk i ka mohuar të pandehurit të drejtën për ankim, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo gjetje nuk përbën shkelje procedurale, të tillë që mund të çojë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

133. Si konkluzion, pas shqyrtimit në tërësi të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë/janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat. Nga Komisioni nuk u vërejtën fakte apo rrethana të tjera që mund të përbëjnë prova për gjetje thelbësore, të tilla që do të mund të ndikonin në vlerësimin përfundimtar në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ritvan Suka. Për më tepër, duket se kjo çështje është ende në fazë gjykimi.

Denoncimet e shtetasve Q.R⁸⁹ dhe H.B⁹⁰ (në dukje anonime)

134. Në ankesën e bërë, shtetasi Q.R referon se shtetasi E.A nuk do të kishte kryer krim në qoftë se nuk do e kishte nxjerrë nga burgju ky prokuror. Sipas denoncuesit, prokurori Ritvan Suka e ka dënuar për armëmbajtje pa leje, megjithëse A i futi 7 plumba një qytetari në Elbasan. Pretendon se ia mbylli ngjarjen “tentativë vrasjeje”, i ndikuar nga veprime korruptive.

135. Në ankesën e bërë, shtetasi H.B kërkon nga Komisioni të kontrollohen disa dosje, për të cilat referon se janë hetuar nga prokurori Ritvan Suka, për të cilat ka paraqitur rrethana konkrete për disa çështje penale, të pasqyruara e listuara si vijon:

⁸⁸ Në mbështetje të deklarimeve të tij, bashkëlidhur prapësimeve ka depozituar si provë shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

⁸⁹ Ankesë nr. *** prot., datë 23.5.2022.

⁹⁰ Ankesë nr. *** prot., datë 5.7.2022.

135.1 E.A qëllon me 7 plumba drejt, në mes të Elbasanit, Xh.R. Ritvani e ndryshon akuzën nga “Tentativë vrasjeje” në “Kanosje”. E nxjerr nga burgu me arrest shtëpie. Referon se këtë qëndrim e ka mbajtur i ndikuar nga veprime korruptive.

135.2 M.Sh qëllon me karikator në Elbasan kundër një personi. Ritvani e akuzon për tentativë vrasjeje. Në gjyq ndryshon akuzën në “Kanosje”. M del nga burgu. Referon se këtë qëndrim e ka mbajtur i ndikuar nga veprime korruptive.

135.3 R.G qëllon me armë zjarri në mes të Elbasanit. Prokurori B.M e akuzon për tentativë vrasje. Dosjen e merr Ritvani. Ndryshon akuzën në gjyq, nga “Tentativë vrasjeje” në “Kanosje”. Referon se këtë qëndrim e ka mbajtur i ndikuar nga veprime korruptive.

136. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁹¹ për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjeve të procedimit penal, ku si persona nën hetim shfaqen shtetasit E.A/A, M.Sh dhe R.G, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se⁹²:

136.1 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 23.4.2018, regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 78 - 22 dhe 278 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. A etj. Me vendimin e datës 25.2.2019, prokurori i çështjes ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. ***, viti 2018 në procedimin penal nr. ***, viti 2018. Procedimi penal nr. ***, viti 2018, me të pandehur shtetasin E.A , i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

136.2 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 20.7.2020. Ky procedim me vendimin e datës 8.10.2020 është bashkuar me procedimin penal nr. ***, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga nenet 78 dhe 278 të Kodit Penal, ndër të tjerë, me person nën hetim shtetasin E.A. Në datën 29.7.2021, dosja hetimore i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

136.3 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 23.10.2017, për veprat penale të parashikuara nga nenet 278/1, 76 e 22 të Kodit Penal, me person nën hetim shtetasin M.Sh . Në datën 17.12.2018, prokurori i çështjes Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Me vendimin nr. ***, datë 24.7.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar fajtor.

136.4 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 26.2.2020, për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/ë - 22 - 25 dhe 278/1 të Kodit Penal, ndër të tjerë, në ngarkim të shtetasit R.G. Në datën 23.10.2020, prokurori i çështjes B.M i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Me vendimin e datës 12.4.2021 është zëvendësuar prokurori B.M me prokurorin Ritvan Suka. Me vendimin nr. ***, datë 29.12.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar fajtor.

Dosja e procedimit penal nr. */***, me të pandehur shtetasin M.Sh**

137. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të dosjes së këtij procedimi penal, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se:

137.1 Në datën 23.10.2017, Policia Gjyqësore ka referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan informacionin për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, “Kanosja” dhe “Prishje e qetësisë publike”, të parashikuara nga nenet 84, 274 dhe 278 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M.Sh, i cili është shpallur në kërkim policor.

137.2 Po në datën 23.10.2017, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka) ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2017, në lidhje me referimin e bërë

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2023, e Komisionit.

⁹² Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

nga policia gjyqësore në ngarkim të shtetasit M.Sh, evidentuar si më sipër. *Duket se ky akt nuk është dërguar i plotë, por është i mangët, pasi rezulton se i mungojnë fletë. Si rrjedhim nuk evidentohen veprat për të cilat është regjistruar ky procedim penal në ngarkim të shtetasit M.Sh.*

137.2.1 Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se për çfarë veprash është regjistruar ky procedim penal, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti ka sqaruar se bazuar në materialin kallëzues të dërguar nga Komisariati i Policisë Elbasan, në datën 23.10.2017, nga Prokuroria është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2017, për veprat penale “Kanosje”, “Prishje e rendit dhe qetësisë publike” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 84, 274 e 278/1 të Kodit Penal⁹³.

137.3 Në datën 2.11.2017, prokurori Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”⁹⁴, parashikuar nga nenet 232/dh dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit M.Sh, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

137.4 Nga verifikimi i këtij akti duket se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan mbi bazën e materialeve të ardhura nga Komisariati i Policisë Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2017, në ngarkim të shtetasit M.Sh, për veprat penale “Kanosje”, “Prishje e rendit dhe qetësisë publike” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 84, 274, 278/1 të Kodit Penal. Por, pas veprimeve të kryera deri në momentin e përpilimit të kësaj kërkesë dyshohet se shtetasi M.Sh ka konsumuar elementet e veprave penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

137.4.1 Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke i kërkuar të konfirmojë nëse është bërë prej tij urdhri për regjistrimin e emrit të personit nën hetim në regjistrat përkatës e, në këtë kontekst, të informojë Komisionin nëse ka pasur urdhër për pasqyrimin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale që i atribuohet personit nën hetim në urdhrin e regjistrimit penal.

137.4.2 Nëpërmjet prapësimeve subjekti shpjegon se me ligjin nr. 35, viti 2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 23.1.1995, “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, në nenin 48 të tij parashikohet se: “Në nenin 287 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Pika 2 numërohet pika 3. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: “Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni”. Duke qenë se me këtë ligj u bënë ndryshime shumë rrënjësore të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e trupës së prokurorëve është dashur një kohë e caktuar për implementimin e praktikës në lidhje me këto ndryshime. Në vijim, subjekti sqaron se koha kur është regjistruar ky procedim penal ka qenë një periudhë thuajse dy muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve dhe se për këtë shkak në mungesë dhe të praktikës, prej tij nuk është urdhëruar me akt të veçantë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale në zbatim të përcaktimit të këtij neni. Subjekti parashtron se në praktikën përpara ndryshimeve nuk ekzistonte e parashikuar në ligj që ndryshimi i cilësimit juridik të pasqyrohej me akt të veçantë gjatë hetimeve paraprake, por ky ndryshim shprehej nëpërmjet njoftimit të akuzës, ku edhe përcaktohej vepra penale për të cilën akuzohej përfundimisht personi nën hetim.

⁹³ Në mbështetje të deklarimeve të tij, bashkëlidhur prapësimeve ka depozituar urdhrin për regjistrimin e procedimit penal datë 23.10.2017.

⁹⁴ Kërkesë e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

137.4.3 Komisioni vëren se me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal të datës 23.10.2017, prokurori Ritvan Suka njëkohësisht ka urdhëruar që në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim M.Sh.

137.5 Në datën 3.11.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur⁹⁵: (i) pranimin e kërkesës së organit të Prokurorisë; (ii) të caktojë si masë sigurimi për personin në hetim M.Sh, i dyshuar për veprën penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal, atë të “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

137.6 Në datën 23.1.2018, prokurori Ritvan Suka ka përpiluar vendimin për caktimin e mbrojtësit kryesisht, duke caktuar si mbrojtës për personin nën hetim M.Sh avokatin O.J, Dhoma e Avokatisë Elbasan.

137.7 Po në datën 23.1.2018, prokurori Ritvan Suka ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 23.10.2017, vendim me të cilin duket se është njohur mbrojtësi i caktuar kryesisht, av. O.J .

137.8 Në datën 26.1.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka) ka dërguar në Gjykatë kërkesën për deklarimin e ikjes⁹⁶ së personit nën hetim M.Sh, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

137.9 Në datën 20.2.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka nxjerrë vendimin “Për deklarim ikje”⁹⁷, të personit nën hetim M.Sh.

137.10 Në datat 23.4.2018 dhe 23.7.2018, prokurori Ritvan Suka ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 23.10.2017, vendime me të cilat duket se është njohur mbrojtësi i caktuar kryesisht, av. O.J.

137.11 Në datën 27.8.2018, djali i personit nën hetim ka emëruar si përfaqësues ligjor të personit nën hetim M.Sh avokatin I.Gj⁹⁸.

137.12 Në datën 23.10.2018, prokurori Ritvan Suka ka vendosur sërish zgjatjen e afateve të hetimit në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 23.10.2017, vendim me të cilin duket se është njohur mbrojtësi i caktuar, av. I.Gj .

137.13 Në datën 4.12.2018, prokurori Ritvan Suka ka vendosur të marrë si të pandehur dhe t’i njoftojë akuzën shtetasit M.Sh, duke e akuzuar për veprat penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal. Me këtë vendim duket se është njohur mbrojtësi i caktuar, av. I.Gj .

137.14 Në datën 6.12.2018, prokurori Ritvan Suka ka njoftuar përfundimin e hetimeve, duke konkluduar se nga ana e të pandehurit M.Sh është konsumuar vepra penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal. Me këtë vendim duket se është njohur mbrojtësi i caktuar, av. I.Gj .

137.15 Në datën 17.12.2018, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***, viti 2017, me të pandehur shtetasin M.Sh, akuzuar sipas neneve 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

⁹⁵ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. regj. themeltar ***(***), datë 3.11.2017.

⁹⁶ Kërkesë e përcjellë me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. *** prot., datë 26.1.2018.

⁹⁷ Vendim nr. ***(***), datë 20.2.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁹⁸ Dokumenti “Prokurë e Posaçme” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.8.2018, redaktuar nga noteri publik, znj. O.G.

137.15.1 Në kërkesën për gjykim, ndër të tjera, prokurori Ritvan Suka ka parashtruar se në bazë të procesverbaleve për këqyrjen e këtyre pamjeve filmike të mbajtura nga policia gjyqësore (i referohet pamjeve filmike të marra në vendin e ngjarjes në lokalin “***”, i cili ndodhet në afërsi të vendit të ngjarjes, dhe kamerave të bashkisë) rezulton se në këto pamje konstatohet se në orën 12 e 08 min. e 49 sek. deri në orën 12 e 09 min. e 02 sek. vihet re se shtetasi i dëmtuar A.B ka qenë duke debatuar me shtetasin I.Sh. Gjatë debatit ata janë kapur nga rrobat dhe janë goditur me njëri-tjetrin. Në orën 12 e 08 min e 58 sek. vihet re shtetasi i identifikuar M.Sh, i cili në dorë mban një armë zjarri dhe qëllon dy herë drejt në drejtimin e shtetasit A.B, i cili është duke u larguar me vrap.

137.16 Në datën 19.2.2019, pasi ka vlerësuar se mbi bazën e provave të administruara rezulton se kualifikimi juridik i bërë nga organi i akuzës është i drejtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (gjyqtari paraprak) ka vendosur⁹⁹ dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2017, në ngarkim të të pandehurit M.Sh, për veprat penale “Vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve luftarake dhe shpërthyes dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal, me procedurën e gjykimit të zakonshëm.

137.17 Në përfundim të gjykimit të procedimit penal nr. ***, viti 2017, me “Konkluzionet përfundimtare” të drejtuar Gjykatës, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar: (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.Sh për kryerjen e veprës penale “Kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 1 vit burgim; (ii) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.Sh për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje të armëve, armëve luftarake dhe shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 vjet burgim; (iii) Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm duke e dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim.

137.17.1 Në këtë dokument, ndër të tjera, prokurori parashtron se nga provat e administruara gjatë gjykimit nuk u arrit të provohen elementet e veprës penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal, në dëm të shtetasit A.B, pasi i pandehuri M.Sh rezulton se megjithëse ka qëlluar dy herë me armën pistoletë nuk e ka ndjekur të dëmtuarin, i cili për momentin e parë është larguar me vrap dhe më pas qetësisht. Nuk provohet që veprimet e kryera nga ana e të pandehurit M.Sh të kenë qenë me qëllim që të shkaktonin vrasjen e shtetasit A.B . Nga pyetja e dëshmitarëve okularë, të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes, nuk u arrit të provohet akuza ndaj të pandehurit M.Sh, ajo e “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal. Bazuar në nenin 372 të Kodit të Procedurës Penale u ndryshua akuza dhe u kërkuar të procedohet me akuzën e re, pasi nga shqyrtimi gjyqësor fakti doli ndryshe nga ç’ ishte përshkruar në kërkesën për gjykim dhe mbi këtë bazë iu kërkuar gjykatës kompetente që gjykimi të vazhdonte me akuzën e re, me atë të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe jo me atë të “Vrasjes me dashje”, të mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal. Nga ana e Gjykatës u pranua ndryshimi dhe gjykimi të vazhdojë me akuzën e ndryshuar.

137.18 Pas kërtimeve të bëra në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u administrua vendimi nr. ***, datë 24.7.2020, që lidhet me çështjen penale me të pandehur shtetasin M.Sh, nga ku rezulton se Gjykata ka vendosur: (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.Sh për kryerjen e veprës penale “Kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe në bazë të dispozitës së këtij neni dënimin e tij me 1 vit burgim; (ii) Deklarimin fajtor të të pandehurit M.Sh për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve luftarake dhe shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dhe neneve 48/ç dhe 49 të Kodit Penal dënimin e tij me 3 vjet burgim; (iii) Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm duke e dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim.

⁹⁹ Vendimi nr. ***, datë 19.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

138. Me dërgim e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke i kërkuar të japë argumentet/shpjegimet e tij, si dhe të referojë provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje penale, të cilat bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, janë çmuar prej tij, si të tilla, të cilat kanë bërë që të ndryshojë akuzën gjatë gjyqimit, nga “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal në atë të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

138.1 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pasi çështja ka kaluar për gjykim është zhvilluar gjykimi i kësaj çështjeje penale me procedurën e gjyqimit të zakonshëm. Me kërkesën për gjykim prej tij është kërkuar marrja e provave dhe, konkretisht: (i) pyetja e viktimës nga vepra penale, shtetasit A.B ; (ii) pyetja e dëshmitarëve okularë të ngjarjes, shtetasve R.I, K.K, M.B, I.Sh dhe R.I; (iii) administrimi i të gjitha akteve shkresore të këtij procedimi penal.

138.1.1 Subjekti ka referuar se ka dhënë dëshminë e tij para gjykatës shtetasi i dëmtuar nga vepra penale, A.B , dhe se gjithashtu janë thirrur, paraqitur dhe kanë dhënë dëshminë e tyre në gjykatë, në cilësinë e dëshmitarit, shtetasit K.K , M. B , E. B , I.Sh dhe R.I. Ndërsa pas administrimit nga ana e Gjykatës të shkresave nr. *** prot., datë 18.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 18.11.2019, ardhur nga Komisariati i Policisë Elbasan, të cilat provonin se dëshmitarët A.T dhe R.Sh ishin jashtë shtetit, bazuar në nenin 359 të Kodit të Procedurës Penale u bë leximi i thënieve të tyre gjatë hetimeve paraprake. Gjykata, bazuar në nenin 371 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi të bëjë pjesë të fashikullit të gjyqimit procesverbalet e pyetjes së këtyre dy shtetasve gjatë hetimeve paraprake. Gjithashtu, nga ana e Gjykatës bazuar në nenin 357 të Kodit të Procedurës Penale u administruan të gjitha aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2017.

138.1.2 Në vijim, subjekti ka sqaruar se pas administrimit të të gjithë provave të paraqitura nga ana e Prokurorisë, Gjykata, bazuar në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale pranoi kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit M.Sh, marrjen dhe shfaqjen si provë të pamjeve filmike të CD-së. Nga ana e Gjykatës u thirr me qëllim shfaqjen e pamjeve filmike para saj punonjësi i IT-së së Gjykatës. Në seancën gjyqësore në prani të IT-së së Gjykatës u shfaqën pamjet filmike të regjistruara në vendin e ngjarjes ku duket i pandehuri M.Sh me armë në dorë dhe shtetasi A.B, i cili duke u larguar me vrap kthen kokën, sheh të pandehurin, i cili pasi ka qëlluar ul dorën me të cilën mbante pistoletën dhe largohet.

138.1.3 Subjekti ka parashtruar se duke pasur parasysh provat e administruara në gjykatë, dëshmitë e marra dhe pamjet filmike, përpara se prej tij të jepeshin konkluzionet përfundimtare i është kërkuar gjykatës që në bazë të nenit 372 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshojë akuzën nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal, në akuzën e “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Pra, si konkluzion argumenton se ky ndryshim akuze u bë pasi nga të gjitha provat e administruara para gjykatës nuk u provua që shtetasi M.Sh të kishte pasur si qëllim vrasjen e shtetasit A.B .

139. Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, përfshirë edhe provat e shpjegimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni nuk vërejtí problematika thelbësore për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Rítvan Suka. Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë/janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat.

139.1 Ndërsa, për verifikimin e dyshimeve të ngritura për vendimmarrje të bazuar në veprime korruptive, Komisioni vlerëson se kompetencën për vërtetimin e këtyre pretendimeve e ka Prokuroria si organi i vetëm që ushtron ndjekjen penale. Gjithsesi, Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka referuar të dhëna konkrete lidhur me këto pretendime. Për më tepër, ai nuk figuron të kenë qenë palë në këtë proces e, më konkretisht, në kuadër të pretendimeve të ngritura të ketë qenë viktimë e veprës penale, familjar apo përfaqësues ligjor i tij.

139.2 Si konkluzion, trupi gjykues çmon se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë denoncim dhe se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuesit për

gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe/apo figurën e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka.

Dosja e procedimit penal nr. */***, me të pandehur shtetasin R.G etj.**

140. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të kësaj dosjeje penale, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se pas hetimeve të kryera në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2020 (regjistruar në datën 25.2.2020), Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përfaqësuar nga prokurori B.M, në datën 23.10.2020 ka kërkuar dërgimin për gjykim të kësaj çështjeje penale me të pandehur: (i) shtetasin R.G, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79, shkronja “ë”, në lidhje me nenet 22 e 25 të Kodit Penal dhe veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; (ii) shtetasin E.T, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë e të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/ë në lidhje me nenet 22 e 25 të Kodit Penal.

140.1 Në informacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan referohet se me vendimin e datës 12.4.2021 është zëvendësuar prokurori B.M me prokurorin Ritvan Suka. Por duket se ky vendim nuk është pjesë e dosjes së dërguar Komisionit. Pra, rezulton se kjo dosje nuk është dërguar e plotë në Komision, pasi mungojnë një sërë aktesh.

140.2 Gjithsesi, duket se subjekti i rivlerësimit Ritvan Suka është bërë prokuror i çështjes në fazën kur ndaj shtetasve R.T dhe E.T ishin përfunduar hetimet, ishin marrë si të pandehur e u ishte komunikuar akuza, si dhe ishte bërë kërkesa për gjykim nga prokurori B.M , duke bërë edhe cilësimin juridik të veprës penale për secilin të pandehur.

140.3 Në këtë dosje gjendet dokumenti me titull “Konkluzione” (pa datë), i firmosur nga prokurori Ritvan Suka, ku, pasi ka referuar rrethanat e ngjarjes penale, ndër të tjera ka parashtruar se: *“Policia gjyqësore në përfundim të hetimeve ka sugjeruar dërgimin për gjykim të kësaj çështjeje në ngarkim të të pandehurit R.T për veprat penale të parashikuara nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal dhe në ngarkim të shtetasit E.T për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Në datën 1.7.2020, prokurori i çështjes ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës në lidhje me personat nën hetim R.T dhe E.T, nga veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal në veprën penale “Vrasja në rrethana të cilësuar”, të mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga nenet 79/ë e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal për sa i përket personit nën hetim R.T dhe nga vepra penale “Moskallëzimi i krimi”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal në “Vrasja në rrethana të cilësuar”, të mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/ë e 22 e 25, për sa i përket personit nën hetim E.T. Personat nën hetim R.T dhe E.T janë hetuar në mungesë dhe pasi ndaj të pandehurit R.T është zbatuar masa e sigurimit e vendosur, rezulton se ai nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me akuzat e ngritura ndaj tij. Ky procedim penal është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan me kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq me akuzat e parashikuara nga nenet 79/ë – 22 e 25 e 278/1 të Kodit Penal për të pandehurin R.T dhe 79/ë – 22 e 25 të Kodit Penal në lidhje me të pandehurin E.T. Nga shqyrtimi gjyqësor i provave të administruara në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2020 dhe verifikimi i akteve të administruara në fashikull dhe konkretisht nga këqyrja e pamjeve filmike të administruara gjatë hetimeve paraprake dhe deklaratimet e të pandehurit R.T rezulton se në bazë të pamjeve filmike i pandehuri R.T ka qëlluar një herë të vetme në drejtim të oborrit të banesës ku largohet viktimja nga veprat penale shtetasi E.B. ...Nga pamjet filmike nuk rezulton se veprimet e kryera nga i pandehuri R.T të kenë qenë të rrezikshme për jetën e shumë personave... Nga pamjet filmike rezulton se i pandehuri E.T ka qenë në vendin e ngjarjes në momentin kur ka ndodhur debati mes të pandehurit R dhe viktimës nga vepra penale, E.B. Po kështu, rezulton se i pandehuri E ka qenë në momentin kur i*

pandehuri R ka qëlluar me armë zjarri, por nuk rezulton që ky shtetas të ketë kryer ndonjë veprim tjetër ndaj viktimës apo personave të tjerë, të cilët kanë qenë në rrugë në momentin kur ka ndodhur ngjarja. Po kështu, nga deklarimet e dhëna nga i pandehuri R.T rezulton se ai është i penduar në lidhje me ngjarjen dhe deklaroi se qëllimi që ai ka qëlluar nuk ka qenë të dëmtojë shtetasin E.B, por ka dashur vetëm ta trembë, me qëllim që ai të largohet dhe të mos kryejë më veprime, të cilat ai sapo i kishte kryer ndaj mjetit me të cilin udhëtonin dy të pandehurit. Nga provat e shqyrtuara gjatë seancës paraprake, si dhe nga tërësia e akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezulton se nga ana e të pandehurve R.T dhe E.T nuk janë konsumuar elementet e veprës penale “Vrasja në rrethana të cilësuar”, të mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/ë - 22 e 25 të Kodit Penal. Nga provat rezulton se i pandehuri R.T ka konsumuar në të gjitha elementet e tyre veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal, ndërsa i pandehuri E.T ka konsumuar në të gjithë elementet e saj veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal”.

140.4 Për sa ka parashtruar më sipër, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar të kalohet për gjykim çështja penale nr. ***, viti 2020, ndaj të pandehurit R.G, me akuzën e parashikuar nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal dhe për të pandehurin E.T, me akuzën e parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

140.5 Pra, duket se gjatë apo pas zhvillimit të seancës paraprake për shqyrtimin e kërkesës së bërë më parë nga prokurori B.M për dërgimin e çështjes në gjyq, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar ndryshimin e cilësimit të veprave penale për të pandehurit R.T dhe E.T .

140.6 Në datën 1.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (përfaqësuar nga gjyqtari T T) ka vendosur¹⁰⁰ pranimin e kërkesës – dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2020, në ngarkim të të pandehurve: (1) R.G , akuzuar për kryerjen e veprave penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, në formën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake në mjediset publike, parashikuar nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal; (2) E.T , akuzuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

140.7 Rezultoi se në përfundim të gjykimit të procedimit penal nr. ***, viti 2020, me “Konkluzionet përfundimtare” të datës 13.12.2021, drejtuar Gjykatës, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar: (i) deklarimin fajtor të të pandehurit R.T për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, në formën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake në mjediset publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 6 vite burgim; (ii) deklarimin fajtor të të pandehurit R.T për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iii) në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit R.T me 6 vite burgim; (iv) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e masës së dënimit në lidhje me të pandehurin R.T me një të tretën, duke e dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim; (v) deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim; (vi) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e masës së dënimit në lidhje me të pandehurin E.T me një të tretën, duke e dënuar përfundimisht me 1 vit burgim.

140.8 Pas kërkimeve të bëra në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u administrua vendimi nr. ***, datë 29.12.2021, nga ku rezultoi se Gjykata ka vendosur: (i) deklarimin fajtor të të pandehurit R.T për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 6 muaj burgim; (ii) deklarimin fajtor të të pandehurit R.T për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, në formën

¹⁰⁰ Vendimi nr. ***/***, datë 1.6.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

e mbajtjes pa leje të armëve luftarake në mjedise publike, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 6 vite burgim; (iii) në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit R.T me 6 vite burgim; (iv) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e masës së dënimit në lidhje me të pandehurin R.T me një të tretën, duke e dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim; (v) deklarinin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim; (vi) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e masës së dënimit në lidhje me të pandehurin E.T me një të tretën, duke e dënuar përfundimisht me 1 vit burgim.

140.9 Nga shqyrtimi i materialeve të kësaj dosjeje duket se prokurori B.M ka vendosur cilësim të ndryshëm të veprës penale, të dyshuar si të kryer nga personat nën hetim nga veprat e referuara nga policia gjyqësore dhe për të cilat ishte regjistruar procedimi, duke bërë edhe urdhrin përkatës për regjistrimin e këtyre veprave në regjistrat e emrave të personave nën hetim. Pas një periudhe prej rreth 14 muajsh hetim (shkurt 2020 – prill 2021), ai ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke kërkuar gjykimin e dy të pandehurve edhe për akuzën “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë.

140.10 Komisioni konstatoi se pothuajse menjëherë pasi u bë prokuror i kësaj çështjeje (me zëvendësim), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në seancë paraprake ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke kërkuar heqjen e akuzës “Vrasja në rrethana cilësuese”, mbetur në tentativë për dy të pandehurit, në dukje pa kryerjen e ndonjë veprimi hetimor shtesë deri në këtë fazë të gjykimit, pra pa siguruar ndonjë provë të re.

141. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegimet/argumentet e tij, si dhe të referojë provat mbi të cilat u bazua gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje penale, të cilat, bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, janë çmuar si të tilla, të cilat kanë bërë të kërkojë ndryshimin e akuzës gjatë seancës paraprake, në cilësimin juridik të ndryshëm të veprës penale për dy të pandehurit e kësaj dosjeje. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë mbi arsyet/shkaqet e zëvendësimit të prokurorit B.M nga kjo çështje në momentin që ai kishte bërë kërkesën për gjykim, duke depozituar kopje të praktikës së ndjekur për zëvendësimin e këtij prokurori, përfshirë këtu edhe urdhrin/vendimin e drejtuesit të prokurorisë.

142. Në lidhje me kërkesat e bëra nga Komisioni sa i përket kësaj çështjeje penale, në prapësimet e tij fillimisht subjekti ka paraqitur kronologjinë e veprimeve procedurale të kryera, duke referuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në datën 26.2.2020, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Komisariati i Policisë Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2020. Më konkretisht, nga ana e prokurorit B.M është bërë regjistrimi i procedimit penal nr. ***, viti 2020, në ngarkim të shtetasit R.G , i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 84 e 278/1 të Kodit Penal. Në datën 4.3.2020, prokurori M ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore deri në datën 30.4.2020. Në datën 25.5.2020, oficerët e policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Elbasan kanë mbajtur një relacion përfundimtar në lidhje me hetimet e procedimit penal nr. ***, viti 2020, duke sugjeruar në bazë të nenit 327/1 të Kodit të Procedurës Penale dërgimin në gjyq të të pandehurit E.T për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe të pandehurit R.T për veprat penale të parashikuara nga nenet 84 dhe 278/1 të Kodit Penal.

142.1 Pasi ka evidentuar të gjitha veprimet hetimore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit Elbasan, deri në përpilimin e relacionit përfundimtar, subjekti referon se nga ana e prokurorit B.M pa u kryer asnjë veprim shtesë nga veprimet që kishte kryer policia gjyqësore, rreth 4 muaj e gjysmë pas ndodhjes së ngjarjes në datën 1.7.2020 është marrë vendim për pasqyrimin e emrit të personit nën hetim dhe pasqyrimin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale në regjistrin e procedimit penal, duke urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik në

urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2020, nga vepra penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal në veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/ë dhe 22 e 25 të Kodit Penal, në lidhje me personin nën hetim R.T dhe të shënohet në regjistrin e veprave penale për këtë procedim emrin e shtetasit E.T , i dyshuar për kryerjen veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” të mbetur në tentativë, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/ë e 22 e 25 të Kodit Penal.

142.2 Më tej, në prapësimet e tij subjekti i rivlerësimit evidenton veprimet hetimore dhe/ose procedurale të kryera nga prokurori M deri në kërkesën për dërgimin në gjykim të çështjes penale, si vijon: (i) Në datën 6.7.2020 i është drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit ndaj këtyre dy shtetasve. Në datën 7.7.2020, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin nr. *** ka vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasve R.T dhe E.T , të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/ë e 22 dhe 25 e 278/1 të Kodit Penal; (ii) Në datën 13.7.2020 ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik dhe caktimin e ekspertit në lidhje me pamjet filmike të sekuestruara nga DVR-ja, duke i kërkuar ekspertit që të përcaktojë nëse në DVR-në e pamjeve filmike të sekuestruara ka mbivendosje, ndërprerje apo ndërhyrje në kohëzgjatjen e regjistrimeve, të nxirren dhe të evidentohen të gjithë personat që konstatohen, të përcaktohet nëse sendi që ka njëri nga personat është armë zjarri ose jo; nxjerrja e këtyre pamjeve të shoqërohet me fotografi. Në datën 16.7.2020, eksperti i caktuar nga prokurori ka përpiluar aktin e ekspertimit teknik; (iii) Pas administrimit të këtij aktekspertimi, në datën 9.9.2020 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesën për deklarimin e ikjes së shtetasve R.T dhe E.T . Në datën 9.9.2020, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin nr. *** ka vendosur deklarimin e ikjes në lidhje me shtetasit R.T dhe E.T , duke u caktuar edhe nga një avokat kryesisht; (iv) Pasi nga ana e policisë gjyqësore është bërë ekzekutimi i vendimit penal nr. ***, datë 7.7.2020, për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në lidhje me shtetasin R.G , si dhe pasi me vendimin nr. ***, datë 24.9.2020, Gjykata ka pranuar kërkesën e organit të prokurorisë për marrjen në pyetje të shtetasit R.G , subjekti i rivlerësimit referon në datën 2.10.2020, pa kryer asnjë veprim hetimor shtesë, se prokurori M ka vendosur marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës ndaj shtetasve R.T dhe E.T ; (v) Në datën 23.10.2023 i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq me të pandehur shtetasit R.T dhe E.T , të akuzuar respektivisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/ë e 22 dhe 25 e 278/1 të Kodit Penal.

142.3 Sa i përket procesit të gjyqimit të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit evidenton se nga procesverbali i seancave të zhvilluara nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezulton se prokurori B.M është thirrur në seancën e datës 25.11.2020 në të cilën është paraqitur; në seancën e datës 18.12.2020 nuk është paraqitur; në seancën e datës 14.1.2021 nuk është paraqitur; në seancën e datës 15.1.2021 nuk është paraqitur. Në seancën e datës 5.2.2021 është paraqitur prokurorja E.T , e cila ka lexuar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj dy të pandehurve dhe ka kërkuar që të administrohen provat. Nga avokatët mbrojtës të të pandehurve, me qëllim qartësimin e pretendimeve në lidhje me akuzën, u kërkuar nga Gjykata shikimi i pamjeve filmike. Gjykata ka vendosur që të shihen pamjet filmike të vendit të ngjarjes dhe për këtë ka thirrur në cilësinë e ekspertit IT-në e Gjykatës, duke shtyrë seancën, me qëllim përgatitjen e kushteve për shfaqjen e këtyre pamjeve filmike. Në vijim, subjekti referon se në seancën e datës 26.2.2022, në prezencë të palëve, nga ana e IT-së së Gjykatës nuk është bërë e mundur shfaqja e pamjeve filmike, për këtë shkak Gjykata ka shtyrë sërish seancën. Seanca gjyqësore e datës 8.3.2021 nuk është zhvilluar, pasi prokurori B.M nuk është paraqitur. Seanca e datës 23.3.2021 nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit. Në seancën e datës 9.4.2021 nuk është paraqitur prokurori B.M .

142.4 Subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin se me vendimin nr. ***, datë 12.3.2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur komandimin e prokurorit B.M në detyrën e përgjegjësit të Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe

Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë për një periudhë dyvjeçare, duke nisur këtë detyrë në datën 19.3.2021. Në datën 19.3.2021, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të materialeve, prokurori B.M ka dorëzuar të gjitha materialet që kishte në hetim dhe në gjykim. Pas njoftimit të këtij vendimi dhe marrjes në dorëzim të materialeve nga kancelarja e Prokurorisë, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me urdhrin nr. ***, datë 25.3.2021, ka urdhëruar trajtimin e materialeve të ndjekura nga prokurori B.M (si në hetim, edhe në gjykim) në seksionet e prokurorisë, duke ndarë çështjet në sektorët përkatës dhe urdhëruar që shefat e sektorëve në bashkëpunim me kancelaren dhe stafin mbështetës të ndanin këto çështje penale nëpërmjet shortit manual. Në datën 12.4.2021, nga ana e drejtuesit të seksionit, në prezencë të prokurorëve të seksionit dhe stafit mbështetës, është organizuar shorti i materialeve të prokurorit B.M , të caktuara për t’u hedhur me short nga drejtuesi i prokurorisë në seksionin e veprave penale të përcaktuara si krime të rënda. Pas hedhjes së shortit është mbajtur procesverbali, ku janë evidentuar çështjet penale për secilin prokuror. Një kopje e këtij procesverbali i është dërguar drejtuesit të prokurorisë, me qëllim marrjen e vendimeve për zëvendësimin e prokurorit B.M me prokurorët e përzgjedhur për secilën çështje nëpërmjet shortit. Për rrjedhojë, në datën 12.4.2021, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Elbasan ka vendosur zëvendësimin e prokurorit B.M në çështjen penale nr. ***, viti 2021, me subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ritvan Suka.

142.5 Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit sqaron se pas marrjes së vendimit të zëvendësimit të prokurorit B.M , në datën 4.5.2021 është paraqitur në seancën e radhës për shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2020. Deklaron se paraprakisht ka kërkuar të informohet se në ç’fazë ishte gjykimi i kësaj kërkesë dhe i është bërë me dije se procesi kishte mbetur në momentin e shqyrtimit të pamjeve filmike. Referon se në këtë seancë nga ana e Gjykatës janë shfaqur pamjet filmike dhe se pas shfaqjes së tyre nga ana e të pandehurve dhe avokatëve janë dorëzuar deklaratimet me shkrim për pretendimet që ata kishin në lidhje me akuzat. Ndërsa prej tij si prokuror është kërkuar kohë, me qëllim ballafaqimin e pamjeve filmike të para në seancë gjyqësore me aktet e dosjes dhe deklaratimet e bëra nga ana e të pandehurit R.T dhe pretendimet e paraqitura nga avokati i të pandehurit E.T . Subjekti ka parashtruar se në seancën e radhës, pas studimit të plotë të dosjes hetimore dhe ballafaqimit të akteve me pamjet filmike të shfaqura nga Gjykata në seancë gjyqësore, si dhe deklarimin e të pandehurit R.G , ka paraqitur konkluzionet përfundimtare, duke kërkuar që çështja penale në ngarkim të të pandehurve R.T dhe E.T të mos shkojë në gjykim për akuzat e parashikuara nga nenet 79/ë e 22 (“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e mbetur në tentativë) dhe 278/1 të Kodit Penal, por të ndryshohet në akuzën e parashikuar nga nenet 84 (Kanosja) dhe 278/2 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit R.T dhe me akuzën “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal për të pandehurin E.T , pasi sipas tij nga studimi i të gjitha provave të grumbulluara fakti penal nuk ishte siç është përshkruar në kërkesën për gjykim.

142.6 Subjekti ka evidentuar faktin se në seancat gjyqësore të zhvilluara për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në seancat gjyqësore të zhvilluara për gjykimin në themel të kësaj çështjeje penale, shtetasi E.B (viktima e veprës penale) nuk është paraqitur asnjëherë, megjithëse në të gjitha rastet ka marrë njoftim nga ana e gjykatës. Nga kërkimet e bëra prej Komisarariatit të Policisë Elbasan është konfirmuar fakti që ky shtetas ndodhej jashtë shtetit. Gjatë gjykimit të kërkesës për dërgimin në gjyq të kësaj çështjeje, në disa seanca viktimja është përfaqësuar nga avokati i caktuar prej tij dhe më pas është përfaqësuar nga avokatë të caktuar kryesisht nga gjykata.

142.7 Në përfundim të shpjegimeve të tij lidhur me këtë çështje, subjekti evidenton vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila i ka shpallur fajtorë dy të pandehurit sipas veprave penale të konkluduara prej tij, si dhe faktin se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës (referon vendimin nr. ***) .

142.8 Komisioni vëren se në mbështetje të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje subjekti ka depozituar kopje të njësuar me origjinalin të fashikullit të plotë të çështjes penale nr. ***/***,

ku përfshihen edhe procesverbalet e seancave gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për dërgimin e çështjes dhe ato të gjykimit në themel.

143. Sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, në raport me shpjegimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni nuk vërejtí problematika për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka. Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, janë/janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat.

143.1 Mbi dyshimet e ngritura për vendimmarrje të bazuar në veprime korruptive, Komisioni vlerëson se kompetencën për vërtetimin e këtyre pretendimeve e ka prokuroria si organi i vetëm që ushtron ndjekjen penale. Gjithsesi, Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka referuar të dhëna konkrete lidhur me këto pretendime. Për më tepër, edhe në këtë rast nuk figuron që denoncuesi të kenë qenë palë në proces, e më konkretisht në kuadër të pretendimeve të ngritura të ketë qenë viktimë e veprës penale, familjar apo përfaqësues ligjor i tij.

143.2 Si konkluzion, trupi gjykues çmon se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë denoncim dhe se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe/apo figurën e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka.

❖ Çështje të tjera – trajtuar në kriterin e vlerësimit profesional

144. Siç u pasqyrua edhe më sipër, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni administroi informacion dhe dokumentacion¹⁰¹ për disa çështje penale, të referuara si të hetuara nga subjekti i rivlerësimit Ritvan Suka në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Çështjet penale me person nën hetim shtetasin F.Ç

145. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjeve të procedimit penal, ku si person nën hetim shfaqet shtetasi F. Ç, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se:

145.1 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 30.1.2006, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78 - 22 - 25 dhe 278/2 të Kodit Penal, pezulluar në datën 30.11.2007 dhe rifilluar në datën 25.9.2018. Ky procedim penal i referohet ngjarjes së datës 30.1.2006, në të cilën është tentuar të vritet me armë zjarri shtetasi F.M. Në datën 7.10.2019, prokurori i çështjes Ritvan Suka ka dërguar për gjykim të pandehurin F.Ç, të akuzuar sipas neneve 78/1 - 22 - 25 të Kodit Penal dhe ka kërkuar pushimin e hetimeve për nenin 278 të Kodit Penal. Dosja i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

145.2 Ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2006, për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78 e 25 dhe 278 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve B.M dhe F. Ç . Procedimi penal është pezulluar nga prokurori i çështjes në datën 31.12.2007 dhe aktet i kanë kaluar DVP-së Elbasan. Në datën 20.6.2018, mbi bazën e relacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria ka vendosur rifillimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2006. Me vendimin e datës 20.6.2006 është vendosur zëvendësimi i prokurorit M.T në kuadrin e procedimit penal nr. ***, viti 2006, me prokurorin Ritvan Suka. Çështja ndodhet në hetim.

¹⁰¹ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 27.9.2023 dhe shkresa kthim përgjigjeje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me nr. *** prot., datë 6.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.10.2023).

Çështja penale me person nën hetim shtetasin E.Q

146. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjeve të procedimit penal, ku si person nën hetim shfaqet shtetasi E.Q , Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2021, për veprën penale “Prodhimi dhe shpërndarja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E.Q etj. Në datën 23.9.2022, prokurori i çështjes i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2023, e ka deklaruar fajtor.

146.1 Më konkretisht, pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të kësaj dosjeje penale, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se pas hetimeve të kryera (ku rezulton se janë përdorur edhe metoda speciale të hetimit), prokurori Ritvan Suka në datën 23.9.2022 ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, viti 2021, me të pandehur shtetasit: (1) E.Q , i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/2 e 291 të Kodit Penal; (2) E. B., E. Q., K. Q., V. C., A. B., A. C, A. B. dhe A. B., të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal; (3) G. M., akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/2, 197 dhe 291 të Kodit Penal; (4) R. A., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

146.2 Sipas informacionit të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, por edhe nga verifikimi i vendimit nr. ***, datë 6.4.2023, të administruar nga faqja zyrtare, duket se Gjykata ka deklaruar fajtor shtetasin E.Q dhe disa shtetas të tjerë.

147. Si konkluzion, pas verifikimit dhe analizimit të kësaj dosjeje gjyqësore penale dhe akteve pjesë përbërëse të saj, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe dokumentacion, mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka, për aspekte që lidhen me kriterin etiko- profesional.

Çështja penale me person nën hetim shtetasin S.M

148. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjeve të procedimit penal, ku si person nën hetim shfaqet shtetasi S.M , Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 20.7.2020. Me vendimin e datës 8.10.2020 është bashkuar me procedimin penal nr. ***, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga nenet 78 dhe 278 të Kodit Penal, ndër të tjera me person nën hetim shtetasin S.M . Në datën 29.7.2021, dosja hetimore i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Çështja penale me person nën hetim shtetasin A.Sh

149. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni për vënien në dispozicion të fashikullit të plotë të dosjeve të procedimit penal, ku si person nën hetim shfaqet shtetasi A.Sh, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informon se ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 6.2.2020, për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/b - 22, 242 dhe 290/1 të Kodit Penal, me person nën hetim shtetasin A.Sh. Në datën 3.2.2022, prokurori i çështjes Ritvan Suka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për gjykim. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2022, e ka deklaruar fajtor. Më konkretisht, pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikullit të kësaj dosjeje penale, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni konstaton se:

149.1 Në datën 6.2.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (prokurori Ritvan Suka) ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit” mbetur në tentativë, “Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësve të policisë” dhe “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuara nga nenet 79/b e 22, 242 dhe 290 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.Sh , për ngjarjen e ndodhur në hyrje të qytetit të Elbasanit, ku

ky shtetas, pasi u është shmangur më parë disa postblloqeve të Korçës, Pogradecit, Përrenjasit, Librazhdit, në qytetin e Elbasanit ka aksidentuar punonjës policie (të cilët kishin ngritur postbllok për ndalimin e tij) dhe disa shtetas të tjerë.

149.2 Pas hetimeve të kryera, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, viti 2020, me të pandehur shtetasin A.Sh , i akuzuar sipas neneve 79/b e 22, 242 dhe 290/1 të Kodit Penal.

149.3 Në përfundim të gjykimit të procedimit penal nr. ***, viti 2020, me “Konkluzionet përfundimtare” drejtuar Gjykatës, prokurori Ritvan Suka ka kërkuar: (i) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/b e 22 të Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 30 vite burgim; (ii) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësve të policisë”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal dhe, në bazë të dispozitës së këtij neni, dënimin e tij me 3 muaj burgim; (iii) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të këtij neni, dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iv) aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal.

149.4 Në datën 5.4.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: (i) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Goditja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 273/3 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim; (ii) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 48/ç të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 vit burgim; (iii) deklarin fajtor të të pandehurit A.Sh për kryerjen e veprës penale “Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësve të policisë”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 muaj burgim; (iv) në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit A.Sh në një dënim të vetëm prej 6 vjetësh burgim.

149.5 Referuar nenit 15/1 të udhëzimit nr. 12, datë 20.7.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”, në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit në lidhje me deklarin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit nr. 10192/2009, prokurori brenda tri ditëve nga dhënia e vendimit informon drejtuesin e prokurorisë për vendimin dhe faktin nëse do të ushtrojë ankim.

150. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit, duke i kërkuar të konfirmojë nëse ka ushtruar ankim/apelim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e nëse po, të depozitojë kopje të njësuar të kërkesës ankimore. Në këtë kontekst, të deklarojë nëse në përputhje me nenin 15/1 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.7.2020, ka informuar drejtuesin e prokurorisë brenda tri ditëve mbi vendimin e gjykatës dhe faktin nëse do të ushtronte apelim.

151. Në prapësimet e tij, subjekti ka deklaruar se pas dhënies së vendimit, referuar nenit 15/1 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.7.2020, ka njoftuar verbalisht drejtuesin e prokurorisë në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të bërë nga gjykata në lidhje me çështjen penale nr. *** të vitit 2020, duke i bërë me dije gjithashtu se ndaj vendimit do të ushtronte ankim. Në vijim, subjekti ka referuar se në datën 5.5.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është bërë hyrje me nr. *** prot., vendimi i plotë nr. ***, datë 5.4.2022, për dënimin e të pandehurit A.Sh . Në datën 17.5.2022, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Penale, prej tij është përpiluar ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. ***, datë 5.4.2022 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2022, një kopje e këtij ankimi i është dërguar

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndërsa me shkresën *** prot., datë 17.5.2022, një kopje e këtij ankimi i është dërguar Prokurorisë së Apelit Durrës.

151.1 Në vijim të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje, subjekti ka referuar se me vendimin nr. *** , datë 26.9.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** , datë 5.4.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me ndryshimin sa vijon: “Deklarimin fajtor të të pandehurit A.Sh për veprën penale “Vrasja e punonjësit të policisë”, të mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/b e 22 të Kodit Penal dhe, bazuar në dispozitën e këtij neni, dënimin e tij me 15 vite burgim. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkimin e dënimeve, përcaktimin e dënimit të vetëm me masën 15 vjet burgim”.

151.2 Komisioni vëren se në mbështetje të deklarimeve të tij subjekti ka depozituar kopje të njësuara me origjinalin të dokumenteve: (i) konkluzione përfundimtare të paraqitura prej tij në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal nr. *** , viti 2020; (ii) vendimin nr. *** , datë 5.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me shënimin e Prokurorisë së Rrethit Elbasan, ardhur në datën 5.5.2022; (iii) ankimin e bërë ndaj vendimit nr. *** , datë 5.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (iv) shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 17.5.2022, me të cilat i është përcjellë ankimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Prokurorisë së Apelit Durrës; (v) vendimin nr. *** , datë 5.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shënimin se ai është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me ndryshimet përkatëse të referuara si më sipër, si dhe se ka marrë formë të prerë në datën 26.9.2022.

152. Për sa më sipër, pas verifikimit, shqyrtimit dhe analizimit të kësaj dosjeje penale dhe akteve pjesë përbërëse të saj, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve të dhëna e provave të depozituara nga subjekti me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, trupi gjykues çmon se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo rrethana të tilla, që të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit profesional apo për figurën e tij.

Dosja e procedimit penal nr. */*****

153. Gjithashtu, bazuar në kërkesën e bërë nga Komisioni, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka dërguar kopje të fashikujve të procedimit penal nr. *** , viti 2021, në të cilën ka gjetur vdekjen shtetasi P.Xh .

153.1 Pas verifikimit dhe shqyrtimit të fashikujve të kësaj dosjeje penale, Komisioni konstaton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar në datën 21.4.2021 procedimin penal nr. *** për veprat penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentativë, “Heqja e paligjshme e lirisë”, e kryer me dhunë në bashkëpunim, “Vjedhja me armë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, “Shpërdorimi i detyrës”, “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “dh” dhe “ë”, 79/b e 22, 110/2, 140, 278/1, 248, 305/b dhe 279/2 të Kodit Penal, në ngarkim të personave nën hetim A.P , A.H, E. E. P, E.G , E.D, J.M, N. K, P.V, R.Xh, T.Y, E.B , K.Xh , A.N, N.P , D. D, P.B , E.B, E.M, D.D, B.K, R.M dhe M.G.

153.2 Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore komplekse dhe përpilimit të një sërë aktesh procedurale që lidhen me këtë çështje dhe personat nën hetim, në datën 7.7.2022 prokurorët e çështjes (Ritvan Suka dhe P.A) kanë vendosur ndarjen e çështjes penale nr. *** , viti 2021, në procedimin penal nr. *** , viti 2021, në ngarkim të personave nën hetim A. P, i dyshuar për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit” e mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit”, “Vjedhja me armë” dhe “Heqja e paligjshme e lirisë”, të parashikuara nga nenet 79/dh dhe ë -22, 278/1, 140 e 110/2 të Kodit Penal; A.H, E.E.P, E.G, E.D, J.M, N.K, P.V e R.Xh për veprën penale “Heqja e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal; A. N, N.P, D.D, P. B, E.B, E.M, D.D e B.K

për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara nga nenet 248 e 305/b të Kodit Penal; E.B për veprën penale “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal dhe në procedimin penal nr. *** për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit në ambiente publike”, të parashikuara nga nenet 79/dh e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K.Xh.; për shtetasit nën hetim M.G T.Y për veprën penale “Prodhimi, mbajtja, blerja, apo shitja e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279, paragrafi 2 i Kodit Penal, të personit nën hetim R.M për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 305/b të Kodit Penal, me qëllim që hetimet të vazhdojnë.

153.3 Në datën 18.7.2022, prokurorët e çështjes (Ritvan Suka dhe P.A) i kanë kërkuar Gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2021, regjistruar për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, mbetur në tentativë, “Heqja e paligjshme e lirisë”, e kryer me dhunë në bashkëpunim, “Vjedhja me armë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit” në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, të parashikuara nga neni 79/b e 22, 110/2, 140 dhe 278/1 të Kodit Penal në ngarkim të personave nën hetim A.H, E E P, E G, E D, J M, N K, P V, R Xh; shuarjen e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit Procedurës Penale, vendosur me vendimin nr. ***, datë 26.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në lidhje me personat në hetim A H, E.E.P, E.G, E.D , J.M , N.K, P.V e R.Xh .

153.4 Po në datën 18.7.2022, prokurorët e çështjes (Ritvan Suka dhe P.A) kanë kërkuar gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2021, në ngarkim të të pandehurit A.P , akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” e Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve A.N , N.P, D. D, P.B, E.B, E. M, D.D e B.K, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 305/b të Kodit Penal dhe në ngarkim të të pandehurit E.B për veprën penale “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal.

153.5 Në vijim të komunikimit me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹⁰², Komisioni u informua se është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2021, për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake, shpërthyese dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79 dhe 278 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K.Xh.

153.6 Nga aktet e dërguara duket se nga procedimi penal numër *** ka pasur një tjetër ndarje, duke u regjistruar procedimi penal nr. ***, regjistruar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake, shpërthyese dhe municionit”, parashikuar nga nenet 79 dhe 278 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K.Xh.

153.7 Në vijim duket se kjo çështje është hetuar nga prokurori A.I, i cili në datën 13.6.2023 ka vendosur ndarjen e çështjes penale nr. ***, viti 2021, në dy procedime: (i) regjistrimin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit K.Xh , për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake, shpërthyese dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79 dhe 278 të Kodit Penal; (ii) procedimin penal nr. ***, viti 2021, për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake, shpërthyese dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278 të Kodit Penal, për hetime të mëtejshme.

¹⁰² (i) Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2023, e Komisionit; (ii) shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.11.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.11.2023).

153.8 Në vendimin e ndarjes, prokurori A.I, ndër të tjera, ka parashtruar se në analizë të faktit penal të hetuar, duke analizuar të gjitha provat veçmas e në unitet mes tyre dhe duke mos i dhënë asnjërës vlerë të paracaktuar, si dhe duke çmuar të gjitha aktet e administruara nga organi procedues gjatë hetimeve paraprake, çështja penale në ngarkim të shtetasit K.Xh duhet të pushohet, për shkak se nuk mund të provohet se është kryer prej tij. Pra, ndodhur në këto kushte, duke qenë se për shtetasin K.Xh hetimet janë të plota, procedimi penal nr. *** i vitit 2021 duhet të ndahet në dy procedime: (i) procedimi penal nr. *** të mbahet në hetim me qëllim zbulimin e autorëve të mundshëm të veprës penale, parashikuar nga neni 79, shkronja “dh” e Kodit Penal; (ii) procedimi penal nr. ***, viti 2021, të kalojë me kërkesë për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit K.Xh .

153.9 Rezulton se në datën 15.6.2023 prokurori A.I ka njoftuar personin nën hetim, K.Xh, për përfundimin e hetimeve, duke referuar se çështja penale në ngarkim të tij duhet të pushohet. Gjithashtu, duket se prokurori I i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit K.Xh. Referuar akteve të administruara, duket se shtetasi K.Xh për një periudhë është hetuar me masën e sigurimit personal “Arrest në burg” (vendimi administrativ-penal nr. ***, datë 25.4.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan), revokuar me vendimin nr. ***, datë 13.5.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

154. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë në mënyrë të përmbledhur shpjegimet/argumentet e tij mbi vendimmarrjet e kryera në funksion të hetimeve të zhvilluara për procedimin penal nr. ***, viti 2021. Gjithashtu, iu kërkua të informonte mbi ecurinë e procedimit penal nr. ***, viti 2021, mbi rrethanat e hetuara prej tij që lidhen me këtë procedim, personat nën hetim, masat e sigurimit të marra ndaj personave nën hetim, provat e administruara në funksion të këtij procedimi penal, mbi vendimmarrjet e mëtejshme për ndarjen e këtij procedimi dhe regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2021 dhe fazën deri në të cilën ai ka qenë prokuror i kësaj çështjeje, duke evidentuar në mënyrë specifike momentin se kur është zëvendësuar si prokuror, i cili ushtronte ndjekjen penale dhe po kryente hetime ndaj shtetasit K.Xh dhe arsyet e zëvendësimit të tij.

155. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara subjekti ka pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecurinë e kësaj çështjeje penale komplekse dhe veprimet e kryera prej tij në cilësinë e prokurorit, në funksion të hetimeve të kryera në lidhje me procedimin fillestar dhe procedimet e regjistruara pas ndarjes së çështjes. Gjithashtu, vërehet se në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë detaje e informacion shterues mbi të gjitha kërkesat e bëra nga Komisioni.

156. Sa më sipër, pas verifikimit, shqyrtimit dhe analizimit të kësaj dosjeje gjyqësore penale dhe akteve pjesë përbërëse të saj, si dhe vlerësimit të tyre në harmoni me shpjegimet e dhëna nga subjekti me prapësimet e depozituara, Komisioni vëren se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo rrethana të tilla, që të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ritvan Suka, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko-profesional.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

157. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara bazuar në *indiciet*/informacionet e përfituara nga institucionet e verifikimit, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

158. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ritvan Suka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS - 1

**TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE
PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. RITVAN SUKA**

Analiza përmbledhëse e treguesve financiarë (vlerat në lek)	2000-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	0	0	-83,048	-92,856	5,142,497	2,965,935	420,091	311,219	489,242	856,613	3,766,990	124,138	150,764	-2,807
Apartament banimi me sipërfaqe 103.2 m2, ndodhur në rrugën ***.					5,078,220	2,217,285	192,038		69,150					
Apartament banimi (bashkëpronësi me bashkëshorten), ndodhur në lagjen ***, Tiranë.										6,169,240		660,720		
Automjet tip *** vit prodhimi 1999, blerë në datë 11.1.2013.										280,420				
Ndryshim likuiditeti	0	0	-83,048	-92,856	64,277	748,650	228,053	311,219	420,092	856,613	-2,682,670	124,138	-509,956	-2,807
B) Detyrime	0	0	0	0	0	1,000,000	0	0	0	0	3,505,250	0	500,000	0
Kredi pranë Bankës Raiffeisen						1,000,000								
Kredi pranë Bankës Societe Generale											3,505,250			
Kredi pranë BKT													500,000	
C) Pasuri neto (A-B)	0	0	-83,048	-92,856	5,142,497	1,965,935	420,091	311,219	489,242	856,613	261,740	124,138	-349,236	-2,807
D) Të ardhura	2,167,326	981,459	783,984	983,258	6,224,922	2,158,355	1,140,040	969,474	1,576,708	1,575,605	1,865,186	1,379,445	1,468,687	1,341,943
Të ardhura nga paga e subjektit	2,167,326	981,459	783,984	983,258	1,146,702	926,530	1,140,040	969,474	1,252,173	1,305,812	1,206,340	1,379,445	1,468,687	1,341,943
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit									324,535	269,793	98,006			
Të ardhura, mundësi kursimi / në formë dhurate - nga babai i subjektit					5,078,220	1,231,825					560,840			
E) Shpenzime	403,728	93,864	113,189	127,568	150,740	430,370	629,238	657,752	937,623	470,603	769,199	1,148,653	1,774,619	1,550,182
Shpenzime jetese	403,728	93,864	109,557	109,557	136,620	136,620	136,620	239,085	273,240	282,048	282,048	659,994	672,828	881,595
Shpenzime për këste kredie pranë Bankës Raiffeisen						255,766	352,488	354,032	356,216	90,438				
Shpenzime për këste kredie pranë Bankës Societe Generale (OTP)											343,627	367,957	361,529	355,295
Shpenzime për këste kredie pranë Bankës BKT													21,232	127,693
Shpenzime për interesat e overdraftit pranë Bankës Raiffeisen			3,632	18,011	14,120	12,116	2,960	2,628						
Shpenzime për interesat e overdraftit pranë Bankës Credins								5,095	10,973	7,861				
Shpenzime për kartën e kreditit pranë Bankës Credins									1,232	9,218	38,367	120,702	108,706	85,599
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit						25,868	137,170	56,912	295,962	81,038	105,158	0	10,324	0
Shpenzime për mobilimin e apartamentit tek **** Tiranë													600,000	100,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	1,763,598	887,595	753,843	948,546	931,685	-237,950	90,711	503	149,843	248,389	834,247	106,654	43,304	-205,432